



المؤسسة الإسلامية للشباب

Fondazioni i Rinisë Islame
Stiftung der Islamischen Jugend
Foundation of Islamic Youth

Seebacherstrasse 67
CH-8052 Zürich
☎ + 41 (0) 43 300 16 70

www.islamischen.ch
✉ Islamischen@freesurf.ch
info@islamischen.ch

بِسْمِ اللَّهِ الرَّحْمَنِ الرَّحِيمِ

N ë emër të A ll-llahut, të Gjithëmëshirshmit, Mëshiruesit!

RRUGA E BESIMIT

Dr. AbdulMexhid Zendani

VLERA E BESIMIT NË ZOT	5
KUSH TË SOLLI NË KËTË BOTË?	5
PASURI E KUJT JEMI NE?	7
PËRSE JEMI KRIJUAR?	9
A JEMI TE HUMBUR?	11
ÇFARË PRESIM NË OBORRIN E PUSHKATIMIT?	17
LIDHJA MË E MADHE	20
DRITA QË LARGON ERRËSIRËN	21
DRITË QË I KAPLON HULUMTUESIT	25
AFRIMI I LLOGARISË	29
BOTA DHE VERTETËSIA E SAJ - E VERTETA	36
BOTA E ARDHSHME	37
BESIMI ËSHTË RRUGA E PUNËS PËR SHPËTIM.....	38
DITURIA ËSHTË RRUGA E BESIMIT	39
RREZIKU I IMITIMIT NË BESIM	40

BESIMI ËSHTË RRUGA E LUMTURISË (DHE SHTOHET ME PUNË TË MIRA).....	41
CIVILIZIMI NË NGUSHTICË (KURSE RRUGËDALJA E TIJ ËSHTË BESIMI NË ZOTIN XH.SH.).....	42
AI I CILI IA KA DHËNË CDO GJËJE KRIJIMIN E VET, PASTAJ E KA UDHËZUAR (ATË).....	47
RRUGA E BESIMIT.....	49
DIJE SE AI ËSHTË QË NUK KA ZOT TJETËR PËRVEÇ ALL-LLAHUT.....	51
ATA JANË SIKURSE KAFSHËT, BILE EDHE MË TË HUMBUR.....	54
KA DËSHMUAR ALL-LLAHU QË AI ËSHTË DHE NUK KA ZOT TJETËR PËRVEÇ TIJ, PO ASHTU MELEKËT DHE DIJETARËT.....	57
ASHTU I SQAROJMË ARGUMENTET PËR POPULLIN QË MENDON.....	58
SHPRESA DHE KUJTIMI.....	59
DËGJIMI DHE MENDIMI.....	66
KOMUNIKIM I DËSHMUAR.....	71
HAPA KONKRETË.....	76
INATI I PABESIMTAREVE.....	78
PROPOZIM DHE KUSHTE.....	83

VLERA E BESIMIT NË ZOT KUSH TË SOLLI NË KËTË BOTË?

O ju të mençur çfarë do të ishte mendimi juaj ndaj atij i cili gjen vetën në një qytet të panjohur ose shkretëtirë, duke ngjarë kjo pa zgjedhjen dhe dëshirën e tij, përpos kësaj i erdhën atij udhërrëfyesit e Atij i Cili e solli në këtë qytet ose shkretëtirë për drejtimin dhe udhëzimin e tij. Mirëpo, atij pas tërë kësaj nuk i intereson që të njoftohet me ata te cilët kanë ardhur për shpëtimin dhe udhëzimin e tij, por përkundrazi kthehet dhe i lufton ata, kurse ata gjenden të qëndrueshëm ndaj mundimeve te tij!? I shan ata, kurse ata afrohen kah ai.

Në të vërtetë përgjigjja e të mençurve do të ishte se: pikesëpari për atë njeri të humbur, i cili është pra në një bote të panjohur nevojitet për të që të kërkojë atë që e ka sjellë në këtë vend të panjohur pa dashjen e tij, që ta dijë fshehtësinë e ardhjes së tij. Nese i gjen udhërrëfyesit të cilët kanë ardhur për udhëzimin e tij, atëherë për të nevojitet që të provojë vërtetësinë e tyre dhe nëse i gjen ata të vërtetë i respekton duke e percjellë rrugën e tyre. Kurse ai i cili nuk interesohet për vetvetën. ose për atë i cili e solli në këtë vend ose për peygamberët e Zotit xhel-le shanuhu nuk ka dyshim se aj njeri është i çmendur dhe abnormal. Nëse i mençuri kujton pak për jetën e tij në këtë botë se si ka qenë tokë e vdekur, e pastaj është bërë njeri i gjallë siç thotë Zoti xh.sh. në Kur'an:

“Nga faktet (e fuqisë) e Tij është edhe ajo, se Ai krijoi prej dheu, e mandej ju (u zhvilluat në njerëz që veproni të shpërndar.” (Rrum: 20).

Sa dallim ka mes botës tokësore të vdekur e cila nuk dëgjon, nuk sheh, nuk mendon, nuk përmirëson, nuk zhvillohet, nuk lind dhe nuk cilësohet me asnjë cilësi prej cilësive të jetësë dhe midis njeriut të gjallë, i cili e ka mbushur tokën me lëvizje dhe aktivitet. Nëse i mençuri mendon në ngjarjen e shpërnguljes së tij prej botës së vdekur në botën e gjallë njerëzore dhe se si është shndërruar toka në spermë prej ujit të turbullt nëpërmes shndërrimit të saj në ushqim, pastaj si është shndërruar sperma në gjak, gjaku në copë mishi, mishi në asht, pastaj i ka mveshur eshtrat me mish, dhe si ka filluar jeta dhe shpirti ne embrionin e femrës? Si ka lidur femijë e pastaj është bërë njeri (komplet) i persosur.

Sikur të mendojmë ndaj të gjitha këtyre çështjeve do të shihet se: asgjë nuk është bërë me zgjedhjen e tij dhe do të dinte se detyra e parë e tij është njoftimi me Atë në duar të të Cilit është ekzistenca, jeta, rritja dhe fizionomia e tij, me Atë i Cili e ka sjellë në këtë botë pa lejen ose zgjedhjen e njeriut siç thotë All-llahu xh.sh. në Kur'an:

“O ti njëri po ç’të mashtroi ty kundrejt Zotit tënd që është bujar e i urtë? I cili të krijoi të ppërsosi dhe të drejtoi. Të formësoi në formën që Ai dëshiroi!” (Infitar: 6-8)

Çka të shtyri të largohesh nga rruga e Zotit o njeri?, I Cili të krijoi, zbukuroi dhe të përsosi? A mendon se ke ardhur në këtë botë vetvetiut? A thua se të krijoi asgjeja, e cila aspak nuk ekziston? A nuk e di se asgjeja nuk krijon gjë, e as ti që ke krijuar diçka prej vetvetës?! Pra patjetër të kesh krijuar që të krijoi: “a thua janë krijuar prej kurgjësë ose ata janë vetëkrijues” (Tur 35). Derisa ekzistenca, jeta dhe krijesa jote është në duart e Zotit xh.sh. i cili të krijoi dhe të përsosi, atëherë patjetër duhet ta njohësh Atë në duart e të cilit është çështja dhe ekzistenca jote. Derisa je rob me dashjen e Tij dhe patjetër të jetë njohuria jote për Zotin tënd detyrë e parë për ty si i mençur.

PASURI E KUJT JEMI NE?

Dora me të cilën ti punon, këmba me të cilën ec, gjuha me të cilën flet, mendja me të cilën mendon, planifikon dhe çdo gjë që shërbehesh dhe e shfrytëzon në trup dhe jetë, pasuri e kujt është?

Por pasuri e kujt je ti? Pasuri e kujt jemi të gjithë ne?

A je ti ai i cili ke zgjedhur ardhjen tënde në këtë botë? A je ti ai që ke zgjedhur babanë ape nënën? A je ti që ke zgjedhur atdheun tënd, apo kohën kur ke lindur? Mos vallë zgjodhe fizionominë dhe cilësitë trupore, shpirtërore dhe mendore, ose të jesh mashkull apo femër? A je ti që zgjodhe për vete të kthehesh në moshen e pleqërisë së dobët pas fuqisë rinore?

A ti deshte të kthehesh në injorancë pas dijes, në sëmundje pas shëndetit dhe në vdekje pas jetës?

“All-llahu është ai që ju knjoi në një gjendje të dobët, pastaj pas asaj dobësie ju dha fuqi, e pas fuqisë dobësi e pleqëri. Ai krijon çka të dojë, Ai është më i dijshmi, më i fuqishmi” (Rrum: 54).

Këto janë çështjet tua më të rëndësishme? Nuk ke asgjë prej tyre, sepse nuk mund të veprosh në njërën prej tyre ashtu siç dëshiron, a je ti i cili ke veprimin në këto çështje sa i përket fëmijëve, të afërmve, familjes qytetit ose popullit tënd? A posedojnë prindërit, të afërmit, familja ose populli diçka për vete prej caktimeve të domosdoshme nga Krijuesi për mua, ty dhe gjithë njerëzit në të kaluarën, të tashmën dhe të ardhmën?!

Pra ti je i sunduar... unë jam i sunduar dhe të gjithë popujt sundimtarë dhe të sunduarit janë robër të Atij i Cili i ka krijuar sipas dëshirës së Tij, I sollli ata në këtë botë, i nxori prej saj dhe ia dhuroi çdo krijese meritat e merituara sipas veprave të bëra.

Pastaj mendo o i mençur për dorën tënde, këmbën tënde a ke krijuar prej tyre mish, asht, gjak ose një qime? Pastaj përseri mendo a i krijove dikujt tjetër diçka prej trupit ose qenies së tij? Gjithashtu thellohu a ke krijuar ndonjë popull, fis ose shtet diçka prej teje ose dikujt tjetër prej njerëzve?

“S’ka dyshim se ata që po i adhuroni ju pos All-llahut, janë të krijuar sikur ju (njerëzit janë më të përsosur” (A’raf: 194).

Tani çfarë është mendimi yt për një person i cili kalon pranë një fabrike, fushe apo zyre dhe po ky hyn në atë fabricë, kopsht apo zyrë duke vepruar me atë që gjën në të, duke ndrequr dhe prishur, ngrit diçka dhe menjanon diç tjetër, si dhe shpërngulë prej një vendi në tjetër pa lejen e pronarit të fabricës, kopshtit apo zyrës?

Në të vërtetë çdo i mençur do të kishte gjykuar me abnormalitet ndaj tij i cili ka vepruar në pasurinë e tjetrit pa lejen e pronarit..,

Tash pyete vetvetën: a je ti prej abnormalëve të cilët veprojnë në gjerat që nuk i posedojnë pa lejen e pronarit...

Nëse i mençuri mendon në vetvete, konstaton se ai nuk ka asgjë prej vetës dhe duhet që të mos veprojë në asgjë, vetëm se me dijen e pronarit të vet dhe të dijë prej tij udhezim si dhe të pranojë urdherat e tij.

“...Ja vetëm Atij i takon krijimi dhe sundimi i madhëruar është All-llahu, Zoti i botëve.” (A’raf:54)
Prandaj është detyrë e parë e njeriut që ta njohë Krijuesin dhe pejgamberin e Tij.

PËRSE JEMI KRIJUAR?

Sikur të ndalen te gjithë mjekët e botës dhe të bëhen rreshë për një duke i pyetur: a është kriuar syri për një qëllim, të gjithë do të përgjigjeshjn: po, ai i cili nuk e pranon këtë qëllim le t’i nxjerrë sytë e vet.

Po ashtu nëse i pyet për gojën, dhëmbët, veshët, hundën, duart, këmbët, zemrën, mushkëritë dhe për çdo gjymtyrë të imët ose qeliza të cilat e përbëjnë trupin e njeriut: a janë këto për qëllim? Me një fjalë do të përgjishin po. Dhe nëse i pyet më gjërë do të thoshin se për këtë gjë nevojitet më se 10 vjet punë për të analizuar krijimin e trupit të njeriut me saktësi dhe përpikshmëri. Edhe nëse i pyet ata, a ka ndonjë farë lidhje në mes qëllimit të një pjesëze të trupit të njeriut dhe qenies së tij në përgjithësi? Përgjigja do të ishte se po në të vërtetë qëllimi i gojës është që ushqejë të gjithë pjesët e trupit, kurse qëllimi i mushkërive është për frymëmarrjen e të gjitha pjesëve të trupit, qëllimi i krijimit të zemrës është që të shpërndajë gjakun në të gjitha pjesët e trupit, qëllimi i këmbëve për mbajtjen e trupit... Kështu pra qëllimi i krijimit të çdo pjese është ta kryejë detyrën e cila ka të bëjë me qenien e njeriut në përgjithësi. Derisa çdo pjesë e trupit është krijuar për një qëllim dhe se qëllimi i organeve tuaja është për shërbimin tënd në përgjithësi, prandaj pa dyshim edhe ti je krijuar për një qëllim.

A e di përse je krijuar, dhe përse janë krijuar të gjithë njerëzit? Derisa ti nuk e di qëllimin e krijimit tënd, atëherë ti je me i pavlefshëm se letra të cilën e ke përpara vetes... në të vërtetë për këtë letër ka qëllim dhe se ajo është për të shkruar në të, derisa në shikimin tënd nuk ka qëllim krijimi yt, atëherë pra, mendo në çeshtjen tënde se si jeton derisa ti nuk e di qëllimin e krijimit tënd. Në të vërtetë, all i cili nuk e di qëllimin e krijimit të gjërave rreth tij është i pakujdesshem ndaj gjithë njerëzve. Dhe ai i cili nuk e din qëllimin e rrobeve të cilat i vesh është edhe me i pakujdesshem se dy të parët. Mirëpo edhe me i pakujdesshem dhe injoranë në mbarë fytyrën e tokës, është ai i cili nuk e di qëllimin e tërë jetës së vet!! mbaron jeta e tij në këtë botë, kurse ai nuk diti përse jetoi e as pse vdiq. Vërtetë jeta e tij në shikimin e vet është më e pavlefshme se kepuçet e tij sepse kepuçet e tij janë për një qëllim kurse sipas mendimit të tij e gjithë jeta është e pavlefshme.

“...e ata që nuk besuan, përjetojnë kënaqësi (në këtë jetë), dhe hanë ashtu si hanë kafshët, e vendi i tyre është zjarri” (Muhammed: 12).

Pra, pabesimtarët jetojnë sikur që ka thenë një poet:

Erdha nuk di prej nga

por erdha

e pashë rrugën para meje dhe eca

do të udhëtoj deshta apo jo

Qysh erdha, si e pashë këtë rrugë.

Nuk e di, dhe pse nuk e di, nuk e di.

Nëse të humburit nuk e dinë qëllimin e krijimit të tyre, ne muslimanët e dime këtë qëllim, dhe nëse nuk e dinë pse nuk e dinë (dhe pse nuk e di) krejt ky qëllim kthehet te fshehtësia e Krijuesit dhe dihet me mësimin i cili na vjen vetëm prej Tij.

Prandaj nuk mund ta dijë njeriu qëllimin e krijimit dhe qenies së tij ndryshe vetëm me udhëzimin e Krijuesit të vet, derisa njeriu nuk e njeh Krijuesin bie vlera e tij ndaj vetvetës dhe nuk është larg për të ta quaj vetën kafshë që flet, kurse Zoti e thërret atë:

“Ne, vërtetë nderuam pasardhësit e Ademit (njerëzit).” (Isra: 70),

Në anën tjetër nuk do njeriu për vete vetëm nënçmim. Prandaj ndër të gjitha këto, detyra e parë e njeriut është ta njoh Zotin xh.sh. dhe peygamberin e Tij.

A JEMI TE HUMBUR?

Nëse njeriu e shikon jetën e njerëzve, do të gjente jetën e shumicës e cila dëshmon se ata janë në humbje. Shenja e humbjes se tyre është ajo se i gjen ata të shpërndarë në rrugë, të luhatshëm në thellësinë e shpirtit, të shqetësuar në ndjenjat e tyre, argument i tyre është logjika, supozimet dhe shpresat dhe kështu pra është jeta e shumë njerëzve të sotëm.

Shtetet e sotme jetojnë në mospajtme dhe grindje, e gjithashtu partitë, grupet, organizatat dhe fiset e këtyre shteteve. Gjithashtu dëshmojmë grindje dhe mospajtme në vetë partinë, organizatën, grupet dhe fiset dhe në brendi të çdo drejtimi, mospajtimi, grindje dhe jete e cila

është në humbje, çka paraqet fshehtësia e këtij mospajtimi? çka fshehet pas jetës së humbur, edhe çka paraqet fshehtësia në këto grindje? Sikur të mendonim pak, do të dishim se shkakut i grindjeve është mospajtimi i njerëzve në fillet dhe idetë, kurse shkakut i ndryshimit të njerëzve është në: fillet dhe idetë në pikat vijuese deri te:

- Ndryshimi njerëzve në njohuritë e tyre që shpie në mospajtimin e mendimeve
- Ndryshimi i njerëzve në moralet e tyre që poashtu shpie në ndryshim mendimesh, deri te mospajtimi i mendimeve,
- Ndryshimi i njerëzve në kuptime dhe mendime që gjithashtu, shpie në mospajtimin e mendimeve të tyre,
- Mospajtimet e njerëzve në përvojat e tyre gjë që shpëie në kundërshtim mendimesh,
- Ndryshimi i njerëzve në interesat e tyre që shpie poashtu në mospajtim mendimesh.

Pasi që mendimi i çdonjerit prej nesh qëndron nëditurinë, moralin, kuptimin, përvojën dhe interesin e tij, pasi që të gjithë njerëzit ndryshojnë në të gjitha këto që u përmendën dhe nuk mund të gjesh dy që dituritë, moralet (sjelljet), kuptimet, përvojat dhe mirësitë t'i bëjë të barabarta dhe të njëjta, atëherë është e pamundur për njerëzit të bashkohen, vetem nëse i bashkojnë mendimet e tyre.

Është e pamundur të bashkohen mendimeë dhe hipotezat (teoritë) vetëm kur t'i bashkojmë njerëzit si dhe t'i bëjmë njohuritë, sjelljet (moralet) kuptimet mendjet, përvojat dhe mirësitë e tyre

të njëjta dhe kjo është me se e pamundur, andaj pra patjetër të ketë ndryshim dhe është e pamundur të bëhet një bashkim dhe unitet absolut mes njerëzve,

“Ata vazhdimisht janë në kundërshtime (mes vete). Përveç atij që mëshiroj Zoti yt.” (Hud: 118-119)

andaj ku qëndron zgjidhja për këtë?

Në të vërtetë e vetmja zgjedhje është ta dinë njerëzit se për ta ekziston një krijues i cili me diturinë e vet ka përfshirë çdo gjë dhe të cilit i takon përsosmëria me e madhe në morale dhe cilesi të tjera dhe për të ka emra të bukur, si dhe ai është lajmëruesi që nuk i ka munguar nga dija e as që i mungon e as që do t'i mungojë ndonjë gjë dhe se Ai është All-llahu i mëshirshëm, para të cilit janë të barabartë në adhurimin e Tij.

“...Ai nuk është i kënaqur me mosbesimin e robërve të Vet.” (Ez-Zumer; 7).

E kur e njohën njerëzit Zotin e tyre dhe hulumtojnë udhëzimin e Tij, dalin nga ai mospajtim dhe shpetojnë vetvetën e tyre nga rezultatet e tij dhe jetojnë si robër të bashkuar (kapur) pëtë litarin e Zotit të tyre, të udhëzuar në udhëzimin e Tij.

“Ata vazhdimisht janë në kundërshtime (mes vete), Përveç atij që mëshiroi Zoti yt...” (Hud: 118-119).

“Ne nuk të shpallëm ty tjetër Kur’anin, vetëm që t’u sqarosh atyre atë për çka u përquanë, e (zbritëm) që të jetë udhëzim e mëshirë për njerëzit që besojnë.” (NahI: 64).

Andaj pra nuk kanë mundësi të dalin njerëzit nga mospajtimet, vetëm atëherë kur ta njohin Zotin e tyre dhe mu për atë është detyra e parë për njeriun ta njoh Zotin xh.sh.

Nëse thellohemi në fshehtësinë e cila ngjall tek njerëzit ndjenjat e frikës nga e panjohura që do të ngjajë të nesërmen ose do ta gjejë atë pas vdekjes, gjithashtu nëse thellohemi në fshehtësinë e asaj frike e cila demoralizon jetën e pabesimtarëve në këtë periudhë të kësaj jete, shohim se fshehtësia është ajo se ata jetojnë në këtë botë duke mos ditur kurrfarë qëllimi të jetës së tyre, nuk e dinë Atë i cili i ka krijuar, nuk e njohin rrugën e cila e pajton krijuesin e tyre dhe as që dinë se çka i pret ata pas vdekjes? Ata vuajnë të frikësuar duke mos u qetësuar, e as që mund të gjejnë qetësi dhe kënaqesi në jetën e tyre, derisa ta njohin Zotin e tyre dhe të besojnë Atë. All-Ilahu xh.sh. në Kur'an thotë:

“O ti shpirt i bindur plotësisht! Kthehu te Zoti yt i vetëkënaqur e i pranuar! Hyn në turmën e robërve të Mi! dhe hyn në xhennetin tim!” (Fexhr: 27-30).

Prandaj detyra e parë është që t'a njohë Zotin dhe Krijuesin e vet.

Nëse thellohemi në fshehtësinë e cila shkakton këso konflikte mes njerëzve, shohim se ajo kthehet te mosnjohja e njerëzve Krijuesin e tyre dhe qëllimin e Tij prej krijimit të tyre, sepse çdo njeriut Zoti xh.sh.i ka krijuar emocione të gjëra, sa që tërë bota nuk mjafton për realizimin e një emocioni të njeriut.

Sikur t'i thuhet dikujt ta kemi dhënë gjysmen a botës, do të thoshte e dua edhe gjysmën tjetër. Pra çka është rezultati i këtyre epsheve të gjëra, të cilat qarkullojnë në trupat e njerëzve? Rezultat i këtyre është konflikti dhe nuk mund të largohet nga ajo derisa është nën hijen e mosbesimit në

Zotin e madhërishëm, sepse pabesimtari mendon se nuk ka jetë tjetër përveç kësaj bote dhe dëfrimeve të saja dhe nuk ka për të prej kësaj bote vetëm ajo çka është dëfryer dhe kënaqur me të. Gjithçka që ka në botë nuk mjafton për realizimin e dëfrimeve, dëshirave dhe kënaqësive të tij, atëherë derisa ai gjen miliona njerëz të ngjashëm me të dhe secili prej tyre don që ta zotërojë botën vetëm, si dhe t'ia nënshtrojë atë mendimit të vet, prandaj patjetër të ketë grindje ndaj kënaqësive dhe interesave të botës së përkohshme!!

Patjetër të ketë konflikte nëpër shtëpi mes vëllzërve dhe grindje në fshat mes familjeve, fiseve dhe bashkësive të ndryshme.

Patjetër të ketë konflikte mes shteteve në tërë rruzullin e tokës. Kjo është praktikë!! Dhe ai i cili nuk e përjeton këtë grindje përgatitet për të! Nuk mund t'i iket kësaj nën hijen e kufrit (mosbesimit), çdo herë që t'i kujtohet njeriut vdekja, dhe sheh se po e befason atë në çdo moment, heton shkurtimin e jetës dhe niset si i çmendur. Në anën tjetër i vleshmi duke shtuar konfliktin, si fitues me kuader sa më të madh prej kënaqësive të botës para se të mbarojë jeta e tij. Kështu pra paraqet konflikt ndaj interesave të botës duke i përdorur në të të gjitha armët dhe tradhëtitë sa do që janë të këqija dhe të rrezikshme, kjo është gjë e cila ndodh...

Nuk mund t'i iket asaj nën hijen e mosbesimit, vetëm nëse i dorëzohet mireseardhjes së besimit, sepse besimtari e di se Zoti i Madhërueshëm i ka premtuar çka i mjafton për emocionet dhe epshet e tij në xhennetin, gjerësia e të cilit është sa qiejt e toka. Zoti ka përgatitur në të pët besimtarët gjithçka dëshirojnë shpirtërat e tyre dhe kënaqen me të sytë e tyre dhe ata janë në të përgjithmonë siç thotë All-llahu xh.sh.:

“(Robërit e Mi të cilët besuan argumentet tona dhe ishin muslimanë. Hyjni në xhennet, ju gratë tuaja, të gëzuar! Atyre u shërbejnë me enë e gastare nga ari, aty do të kenë çka t’u dëshirojë shpirti dhe t’u kënaqet syri. Ju do tëjeni aty përgjithmonë” (Ez-Zuhruf: 69- 71).

Pra e din besimtari se nuk do të arrij t’i ketë këto kënaqësi të përhershme dhe nuk do të mundet t’i shmanget zjarrit të xhennemit ndryshe vetëm nëse kalon në provimin e respektit ndaj Zotit të tij të cilit ia kushton gjat jetës dhe qëndrimin të tij në rruzullin tokësor. Në të njejtën kohë e din besimtari se nuk mund të kalon në provim ndryshe vetëm nëse i zbaton urdhërat e Zotit xh.sh. dhe largohet nga ndalesat e Tij. Po ashtu e din se Zoti xh.sh. e ka urdhëruar atë që ti shfrytëzon të mirat e kësaj bote në mënyrë të lejuar (hallall) ajo çka i takon atij prej saj pa mashtrime gënjeshtrike, mallverzime etj., sepse në të ka aq sa i mjafton atij dhe familjes së tij bile edhe aq sa që nuk ka nevojë besimtari për përdorimin e gjesteve negative to lartëpërmendura, prandaj gjithmonë e gjejmë besimtarin puntorë, të zellshëm, të dobishëm dhe në shërbim të nevojshmeve. Kështu jeton besimtari i vërtetë në një shoqëri në të cilën zëvendësohen cilësitë e këqija me të mira si p.sh.: armiqsitë me dashuri, përçarjet me bashkim, padrejtësia me drejtësi, interesat personale me ato të përgjithshme, hidhërimi me pajtim, mërzia me gëzim e kështu me radhë.

Kështu ka qenë gjehtëria e muslimanëve atëherë kur kanë qenë besimtarë të fortë, të paluhatshtëm në besimin e tyre. Këto cilësi të humbura ende vazhdojnë me mungesa dhe me fshehtësi nëpër shoqëritë islame duke u vërejtur fshehtësia e tyre me aq sa e godit besimin dobësia e shpirtërave të pronarëve të tij (besimit).

Kthehet dhe del në shesh herën tjetër aq sa kthehet besimi dhe vendoset në shpërterat. Prandaj, për besimin në All-llahun xh.sh. dhe pejgamberin e Tij, duhet patjetër të merrë fund kjo grindje

midis njerëzve dhe të kthehet jeta islame në shesh për herë të dytë, sikur që ka qenë herën e parë. Prandaj, detyra e parë dhe me e nevojshme është që njeriu ta njohë All-llahun e Madhërueshëm.

ÇFARË PRESIM NË OBORRIN E PUSHKATIMIT?

Ti dhe gjithçka që ka në tokë do të dilni nga bota për afërsisht gjatë njëqind vjetëve (nëse don All-llahu xh.sh.), pastaj do të jeshë në numrin e të vdekurve. All-llahu Fuqiptotë në Kur'anin famëlartë thotë si vijon:

“Kudo që tëjeni vdekja do t’ju kapë, po edhe në qofshi në pallate të fortifikuara...” (Nisa. 78).

Pra, ti je prej bijve të vdekjes, derisa ti pret kohën e kërkesës tënde për dalje nga kjo botë, sikurse ai i cili del me një grup të madh në oborrin e pushkatimit duke pritur radhën nga e cila nuk ka kurrfare ikje prej saj, po ashtu vdekja ty do të vie mu në momentin e caktuar. Pra, do të zgjohesh me të gjallët, kurse do të zë nata me të vdekurit, ose do të zë nata me të gjallët e do te zgjohesh me të vdekurit. All-llahu xh.sh. ka thënë:

“Agonia e vdekjes i vjen me atë të vërtetën (I zbulohet çeshtja e ahiretit) e kjo është ajo prej së cilës ke ikur” (Kaf: 19).

Nuk ka para teje përpos disa ditë, çdonjera që kalon i afrohet afati i vdekjes.

“Thuaj: “S’ka dyshim se vdekja prej së cilës po ikni ka për t’ju zënë, mandej do të silleni tek Ai që e di të padukshmën dhe të dukshmën, dhe atëherë Ai do t’ju njoftojë me atë që e keni punuar “ (Xhuma: 8).

Do të dalësh me dashje apo me dhunë dhe do të dalin mbretërit, kryetarët dhe të pasurit sikur që kanë dalë popujt përpara. Po ashtu do të dalin personat, të varfër dhe të dobëtit dhe do të dalin të gjithë popujt sikurqe kanë dalë të parët. Pra, të gjithë njerëzit janë robër të Atij i cili i ka ngjallë ata dhe i ka vdekur pa lejen ose zgjedhjen e tyre. Do të lësh pasurinë, sundimin, familjen, shoqërinë, diturinë, punën, profesionin, shëndetin, bukurinë tënde, krejt këto dhe do të kthehet trupi yt në atë prej të cilës ka dalë në fillim, (d.m.th. dheu). Do të vijë momenti kur do të zhveshen eshtrat tua nga mishi yt, do të shkatërrohen te gjitha pjesët e trupit dhe do të bëhet ky trup i gjallë para teje një grusht eshtra në një tubë dhe do të zgjatë vendbanimi yt, sikur që u ka zgjatur popujve përpara. Pra, a e ke pyetur vetvetën për vërtetësinë e mbarimit tënd të përhershëm dhe a ke kuptuar se çfarë do të jetë fati yt në të ardhmën e pafund?!

Ti dhe kush është në këtë botë prej shteteve dhe popujve që e harxhoni gjithë mundin për sigurimin e jetës për disa vjet, ditët e te cilave kalojnë dhe mbarojnë së shpejti? Atëherë çfarë ke përgatitur për të ardhmën tënde të pambarueshme a thua ka atje të ardhshme? A ka jetë pas kësaj jete? A ka lidhje kjo jetë me jetën tjetër? Cila është rruga e shpëtimit dhe fitimit? Kush na i vërteton neve këto lajme?

Në të vërtetë Ai i Cili na ka krijuar për herë të parë prej dheut, nuk është rëndë për Atë që të na ringjallë herën e dytë, pasi që të bëhemi dhe.

Në të vërtetë Ai i Cili e ka zbuluar qëllimin dhe e ka zhvilluar krijimin tend, nuk ka dyshim se gjithashtu ka qëllim të caktuar dhe prej vdekjes tonë që do të zbulohet nëse shpërngulemi në periudhën tonë të re pas vdekjes.

Ai i Cili e ka përsosur krijimin e njeriut prej spermës nuk e le atë të shkojë shkel e shko... Në të vërtetë, Ai i Cili e ka vënë drejtësinë në tokë dhe qiell, do ta vërë atë për punët e njeriut, të mira apo të këqija, do të shpërblehet ditën e gjykimit bamirësi dhe do të dënohet keqbërësi... Ai i Cili i ka dërguar peygamberët, lajmëtar dhe përkujtues prej ditës së Kijametit pas vdekjes në çdo popull nuk e ndryshon premtimin e Tij dhe do t'ua vërtetojë peygamberëve të Vet. Shenjat e afrimit të Kijametit kanë dalë sikur që na ka lajmëruar Muhammedi a.s., prandaj nuk ka ngelur tjetër, vetëm të dëshmojmë ditën e Kijametit ashtu si i kemi dëshmuar shenjat e saj. Është konstatuar se toka i ruan incizimet e punëve tona (me zë ose fotografi) dhe këto incizime të ruajtura nuk janë bërë për asgjë tjetër vetëm se për t'u. prezentuar herën tjetër.

“Kur të dridhet toka me dridhjen e saj të fuqishme.

Dhe do të nxjerrë toka atë që e ka në brendinë e saj (barrën nga brenda). Dhe njeriu të thotë: ‘ç’ka kjo (që bën këtë dridhje)?’. Atë ditë, ajo i rrëfen tregimet e veta. “ (Zelzele: 1-4)

Ai i Cili e ka filluar krijimin pastaj e kthen përsëri, është në gjendje që ta kthejë përsëri krijimin tënd herën e dytë sikur që e ka filluar atë herën e parë.

Në të vërtetë çështja është e rrezikshme... e ajo është çështja e së ardhshmes dhe mbarimit të përhershëm.

Pra, jetë të këndshme ose jetë xhehennemi, nuk mund të zhduket prej teje frika e së ardhshmes së panjohur, vetëm nëse bindesh për vërtetësinë e peygamberëve të All-llahut të Madhërishëm dhe u binde se ajo çka të lajmëron me të, është e vërtetë prej Zotit xh.sh. i cili të ngjall dhe ta merr shpirtin dhe të ringjall, atëherë do të qetësohen nervat dhe do të jetë jeta e gëzuar, do të largohet frika dhe dridhja nga mbarimi i paditur që e pret çdokënd, por ky lloj mbarimi do të jetë vetëm për ata të cilët besojnë në All-llahun xh.sh. dhe peygamberet e Tij. Prandaj detyra e parë për njerëzit është që ata ta njohin Zotin e tyre dhe t'i pranojnë peygamberët e Tij si të vetmit udhëzues.

LIDHJA MË E MADHE

Në të vërtetë njeriu i mençur ndjen dhe heton dobësinë e tij ndaj fuqisë së krijimit të vet i cili e përdor (vepron) sikur që do. Pra, Zoti i Madhërueshëm është krijuesi dhe sunduesi e kurse ai vetë është i krijuari dhe i sunduari. Zoti është i pasur, kurse ai i varfër. Zoti është sundues, dominues dhe shkatërrues (zhdukës), kurse ai është i nënshtruar dhe i përulur ndaj sundimit të Zotit. Pra, njeriu është i habitur, i luhatur dhe injorant, kurse Zoti i tij është i ditur, udhëzues dhe drejtues që e ka mësuar njeriun për atë çka nuk di.

Nuk ka më të nevojshëm se krijesa e sunduar, e dobët dhe frikësuar për krijuesin dhe sunduesin e Plotfuqishëm, të krenar dhe dhurues. Nuk ka më të nevojshëm se njeriu i varfër, i përulur dhe i

nënshtuar për Zotin e tij të pasur, dominues dhe shkatërrues. Nuk ka me të nevojshëm se robi i habitur, luhatur dhe injorant për zotëriun e tij udhëzues, drejtues dhe dijetar.

Në të vërtetë njeriu është më se i nevojshëm për realizimin e lidhjes së përhershme me Zotin e tij, nëse e realizon atë e siguron vetën nga frikat dhe jeton nën hijen dhe mbrojtjen e Zotit të tij i sigurt, i qetë dhe i lumtur. Sikur që është gjendja e muslimanëve të vërtetë. Por ky fat, mbrojtje dhe butësi zotërore, ndihmë dhe përqendrim nuk realizohet ndryshe vetëm pas realizimit të lidhjes me interesante mes krijesës dhe krijuesit të tij, kjo është lidhja e besimit në All-llahun xh.sh. dhe pejgamberin e Tij, sepse ai është udhëzues në sqarimin e asaj lidhjeje. Kështu pra, ai dimë se detyra e parë e njeriut është njohja mbi Zotin dhe pejgamberin e Tij, Muhammedin a.s.

DRITA QË LARGON ERRËSIRËN

- Kush nuk e njeh All-llahun e Madhërueshem, ai jeton në errësi.
- Kush nuk e njeh sunduesin e vet dhe ndryshuesin e gjendjes së tij sikur që do, ai jeton në errësi.
- Kush nuk e di qëllimin e krijimit të vet, ai jeton në errësi.
- Kush nuk e di udhëzimin dhe dritën e cila ka ardhur prej Zotit të tij, ai jeton në errësi.
- Kush nuk e di mbarimin në të cilin shkon çdo ditë dhe shpërngulet në të me vdekje, ai jeton në errësi.

- Kush nuk e di rrugën e jetës nën hijen e kënaqësive dhe mbrojtjes së Zotit, ai jeton në errësirë.
- Kush nuk e di rrugën e daljes nga këto errësira, ai do të mbetet në to dhe nuk mund të dalë kurrnjëherë.

Nëse thellohet i mençuri dhe kujton, do ta shoh se nevoja e tij për udhëzim dhe dritë e cila e nxjerr nga këto errësira, ka përparësi, ndaj të gjitha nevojave tjera.

Nëse mendon i mençuri për çështjen e Krijuesit të vet, do të shohë se i plotfuqishmi ka drejtuar çdo gjë në situatë më të mirë që pajtohet me krijimin dhe qenësinë e tij, shoh se çdo pore dhe nervë në trupin e njeriut, çdo organ, imtësire-pjesë dhe aparat në të, është krijuar në vend të përshtatshëm dhe është udhëzuar në çështjen që i përshtatet krijimit dhe qenësisë së tij. Po ashtu çdo pjesë e bimëve prej kërcyve, gjetheve, luleve, lëndëve dhe frutave sikurse edhe çdo organ dhe pjesë e kafshëve dhe çdo pjesë e tokës prej ujit, ajrit, dheut, kodrave, natës, ditës, verës, dimrit, vjeshtës, pranverës sikurse krejt yjet e qiellit dhe planetet e tij, çdo gjëje i është caktuar krijimi dhe udhëzuar në atë çka i përshtatet krijimi sepse krijuesi është i cili ka krijuar dhe barazuar dhe i cili ka caktuar dhe udhëzuar dhe Ai është:

“I cili krijoi dhe përsosi. Dhe i cili përcaktoi e orientoi“ (A’ëla: 2-3).

Nëse thellohet i mençuri në tërë këtë që u përmend, gjen se krijuesi ka udhëzuar atë çka është më i vogël dhe më i madh se ai (njeriu) dhe përfundon mendja e tij se Zoti i Madhërueshëm është drejtues dhe nuk e lë atë pa udhëzim dhe drejtim.

Nese mendon njeriu në krijimin dhe qenien e vet, gjen se All-llahu xh.sh. e ka krijuar atë të nevojshëm për ajër, dritë, ushqim, tesha dhe shtrat, gjak, mish, eshtra, dhëmbë dhe për të gjitha pjesët e trupit duke krijuar dhe plotësuar të gjitha nevojat e tij. E krijoi atë të nevojshëm për largimin e ndytësirave nga brendia e trupit te tij, andaj i drejtoi këto ndytësira në rrugën e tyre. Derisa Zoti i Madhërueshem i ka udhëzuar pjesët më të imta të njeriut, atëherë nuk dyshon i mençuri se Krijuesi i tij nuk do ta lërë atë pa udhëzim. Në të vërtetë ka nevojë për dritë, e cila nxjerr atë nga errësirat e injorancës, habitjes, hurnbjes, frikës dhe dyshimit në çështjet me të rëndësishme të jetës dhe qenies së tij.

Nese njeriu ndërton një mjet dhe e shpie atë duke e drejtuar me atë mjet që njerëzve ua sqaron qëllimin e ndërtimit te tij dhe mënyrën e punës së tij.

Po ashtu krijuesi i njeriut është e pamundshme ta lërë atë pa sqarim ose udhëzim, sepse prej Zotit tonë kanë ardhur drita dhe udhëzimi, kurse pabesimtari bëhet se nuk sheh duke u dalldisur pas epsheve.

“Juveju erdhi i dërguari jonë qëju sqaron shumë nga ajo që fshihnit prej librit, e për shumë nuk jep sqarime. Juve ju erdhi nga All-llahu dritë, dhe libri i qartë. All-llahu e vë me atë (me Kur’anin) në rrugët e shpëtimit atë që ndjek kënaqësitë e Tij dhe me ndihmën e Tij i nxjerr ata prej errësirave në dritë dhe i udhëzon në një rrugë që është e drejtë.” (Maide: 15-16)

Nuk ka asnjë popull në të cilin nuk ka dërguar Zoti xh.sh. pejgamberë:

“...e nuk pati asnjë nga popujt që nuk pati të dërguar” (Fatir 24)

Historia e njerëzimit dëshmon se çdo popull që ka ekzistuar ka pasur fenë e vet sado që t'i ketë pasur bazat e mira e kanë ndryshuar atë ditët.

Nuk ka kurrfarë arsye për atë që do të arsyetohet, sepse e ka bërë Zoti atë dritë për robërit e Vet, prandaj nuk ka arsye për atë i cili ka vendosur që të jetojë në errësirë.

“Të dërguar që ishin lajmgëzues e kërcënues, ashtu që pas dërgimit të dërguarve njerëzit të mos kenë fakt (arsyetim) para All-llahut. All-llhu është i pavarur në sundimin e vet dhe di si të veprojë.” (Nisa: 165)

Ky argument gjendet sot, e ai është Kur’ani, duke e shpërngulur atë në shumë horizonte prej radiostacioneve dhe televizioneve pastër ashtu sikur që e ka zbritur All-llahu i Madhërueshëm, e ka ruajtur Zoti xh.sh. nga çdo ndryshim. Ky është Kur’ani i cili është ruajtur në zemra, janë grumbulluar mundet e dijetarëve në çdo kohë për kujdesin e ruajtjes dhe mësimin e shkencave të tij. Andaj kush është ajo arsye e cila po e vazhdon jetën akoma në errësirë dhe çka do të jetë arsyeja ditën kur do ta pyesë atë Zoti xh.sh. sikur që thotë Zoti i Madhëruar:

“Derisa të arrijnë (në vendin e llogarisë Ai u thotë:

‘A ju i mohuat argumentet e Mia duke mos i menduar dhe formuar dije për to? E çka vepronit ju ashtu (në dunja)?’” (Neml: 84)

Në udhëzimin të cilin e ka dërguar Zoti xh.sh. ka përgjigje të plotë për çdo pyetje të njerëzve, ilaç për zemrat dhe bindje të plotë për të mençurit.

Të mençurit e pranuan udhëzimin e Zotit të tyre dhe e ditën se Ai është i vërtetë.

“Ndërsa atyre që i është dhënë dijenia, e dinë se kjo që të është shpallur ty nga Zoti është e vërtetë dhe se udhëzon për në rrugën e Fuqplotit, të Lavdishmit.“ (Sebe’ë: 6)

Kështu pra, u përgjigjen pasi që e ditën, e çfarë arsyeje ka për kundërshtim ndaj besimit, pasi që iu përgjigjen të tjerët të vërtetës. All-Ilahu xh.sh. thotë:

“Ata që kundërshtojnë fenë e All-llahut pasi që asaj i janë përgjigjur (njerëzit), faktet e tyre janë të asgjësuar te Zoti i tyre, ata janë të përbuzur dhe ata do të kenë denim të rëndë“ (Shura; 16).

DRITË QË I KAPLON HULUMTUESIT

Sikur që iu përgjigjen të mençurit dritës së Zotit xh.sh. po ashtu edhe hulumtuesit prej udhëheqësve të shkencave bashkëkohore në Lindje dhe Perëndim janë kthyer në mirëseardhjen e besimit në Zot, pasi që i kanë larguar ata murgjit dhe priftërinjtë nga feja, sepse priftërinjtë deshtën që t’i detyrojnë me fuqi hulumtuesit në fenë e tyre, te cilën e kanë ndryshuar dhe deformuar, gjë e cila i largoi ata krejtësisht nga feja. Por, sa herë që u munduan hulumtuesit të ikin nga besimi në Zot kanë hasur në dritat e tij, duke zbuluar argumentet e Kur’anit.

Sa herë që kanë shpikur ndonjë teori për ta ndihmuar ateizmin, u ka zbuluar Zoti atyre të vërtetat të cilat i kanë zhdukur hipotezat e tyre të trilluara. Dhe kështu të detyruar nga argumentet e Zotit u bënë thirrës në besim pasi që ishin thirrës në ateizëm. Për fat të keq shumë njerëz në vendet muslimane janë mashtruar me hipotezat e ateizmit të cilat i kanë parashtruar këta hulumtues për

ndaljen e njerëzve nga feja dhe besimi në Zot dhe vazhdimisht mashtrohen me ato hipoteza, duke e ditur se hulumtuesit nuk e kanë bërë atë për asgjë tjetër vetëm se për të ikur nga feja të cilën e kanë deformuar priftërinjtë dhe murgjit duke gënjyer për Zotin. Mirëpo nuk e dinë këta të mashtruar se Muhammedi a.s. ka ardhur duke sqaruar atë që e kanë ndryshuar dhe deformuar dhe se ai ka sinjalizuar për të padrejtën të cilën ia kanë mveshur të krishterët në fenë e tyre para se të zbulojnë hulumtuesit atë të padrejtë me disa shekuj. Nuk e dinë këta të mashtruar sidomos ata të vendeve Islame se udhëheqësit e hulumtimeve shkencore në Lindje dhe Perëndim, janë prej atyre të cilët thirrnin në ateizëm dhe ndytësitat e tij dhe se shumica praj tyre janë bërë prej thirrësve të besimit në Zot. Ja pra, po i paraqesim disa deklaratatë të këtyre hulumtuesve dhe mësimdhënësve në shkencat e ndryshme.

1.. Dr. Voiter Skajlend Berg- shkencëtar i fiziologjisë dhe kimisë organike, ka doktoruar dhe është profesor i fiziologjisë dhe i kimisë në Universitetin Fiota i cili thotë:

“Sa u përket atyre që merren me shkencat dhe të cilët shpresojnë në Zotin, posedojnë kënaqësi të madhe e arrijnë atë sa herë që hasin në zbulim të ri duke u forcuar atyre besimin në Zot si dhe duke u shtuar atyre arritja dhe pamja e fuqisë së Zotit në këtë gjithësi”.

2. Andro Konvaj Ejfi - shkencëtar natyralist dhe eutontet botëror gjatë vitit 1925-1946 ka thënë duke shprehur atë nën titull:

“Qenja e Zotit e vërtetë e kryekeput” ku thotë:

“Duket se ateistët ose dijetarët me gjithë dyshimin që kanë në vete, te ata është një pjesë e errët dhe e mpirë brenda në mendjet e tyre e cila i pengon nga paramendimi se të gjithë këta faktorë pa

marrë parasysh qofshin të gjalla apo të vdekura, mbarojnë pa kurrfarë qëllimi duke mos konstatuar qenjen e Zotit.”

3. Hertshil- astronom anglez thotë:

“Sa do që zgjerohet diapazoni i diturisë aq më tepër shtohen argumentet e forta të cilat drejtojnë në qenjen e Krijuesit të përhershëm, fuqia e të Cilit nuk ka fund e as kufi. Gjeologët, matematicientët, astronomët dhe bioiogët kanë bashkëpunuar dhe ndihmuar për përforcimin e diturisë e cila është vërtetim i Madhërisë së të vetmit Zot.”

4. Dr. Vots - kimist francez ka thënë:

“Nëse hetoj ndonjëherë prej herëve se besimi im në Zotin luhetet, i drejtohem shkencave akademike për ta përforcuar atë (besimin).”

5. Dr. Maret Stanli-natyralist dhe filozof ka thenë:

“Gjithçka që ka në kozmos dëshmon për qenien e Zotit të Madhërueshëm dhe drejton për fuqinë dhe madhësinë e Tij) atëherë kur ne dijararët analizojmë dhe studiojmë Kosmosin deri sa me shërbimin e dokumentacioneve, nuk vërejmë me më tepër se një konstatim mbifuqinë dhe madhësinë e Zotit. Ai është All-llahu te i Cili nuk mund të arrijmë vetëm me anë të komunikatave shkencore materiale por duke i parë argumentet e Tij në veten tonë dhe në çdo imtësi të kësaj gjithësie. Pra, shkencat nuk janë asgjë tjetër vetëm një studim në krijimtarinë dhe fuqinë e Zotit të Madhërueshëm”.

6. Edvard Loteri- ekspert i veterinarisë, pasi që ka sjellë një numër dokumentesh për besimin e tij në Zot ka thënë:

“Është e pamundur që të përfshihen të gjitha argumentet për sqarimin e maturesë së shpikjes dhe përsosjes në këtë gjithësi porse unë kam arritur të zbuloj një numër të madh të këtyre argumenteve gjatë hulumtimeve të mia të kufizuara rreth krahëve të insekteve dhe evolucionit të tyre. Çdo herë që jam thelluar në studimin e gjithësisë më është shtuar bindja dhe më është forcuar besimi me këto argumente. Hulumtimet dhe zbulimet të cilave u kushtojnë rendësi, shkencat për studimin e tyre, nuk janë asgjë tjetër vetëm se dokumente dhe argumente të qarta për qenien e Krijuesit dhe shpikësit të kësaj gjithësie.”

Zoti i Madherueshëm ua ka bërë të mundshme hulumtuesve zbulimin e dokumenteve dhe argumenteve të cilët drejtojnë në qenien e Zotit të Madhërueshëm. Po ashtu ua ka bërë të mundshme atyre zbulimin e çudirave të Kur’anit famëlartë dhe mrekullive të pejgamberit a.s., të cilat i bindin për vërtetësinë e pejgamberizmit dhe shpalljes së Tij (Kur’anit). Këto janë disa deklarata të besimit Islam prej studiuesve dhe hulumtuesve të Lindjes dhe Perëndimit dhe vazhdimisht po shtohen këto deklarata ditë pas dite.

Këto qendra islamike janë themeluar në shumë shtete evropiane dhe amerikane dhe me shumë që e vërteton vërtetësinë e kësaj feje është ajo se ata të cilët hyjnë në këte fe, hyjnë në bazë të njohjes së fesë islame, ndersa ata të cilët dalin nga kjo fe, dalin nga mosnjohja e tyre e fese Islame.

AFRIMI I LLOGARISË

Pra, nëse o i mençur je i nevojshëm për besim sikur që u lartpërmend atëherë ti je me se i nevojshëm për shpëtim nga dënimet dhe ndëshkimet me zjarr, të jesh prej pronarëve të xhennetit dhe se drejtësia e All-llahut xh.sh. refuzon që të barazohen bëmirsit dhe kriminelët. Andaj Krijuesi i qiejve dhe tokës me të drejtë, patjetër t'i vendosë peshojat në çdo çështje të njerëzve Ai i Cili të ka krijuar ty dhe të ka mbrojtur kur ke qenë pikë uji (spermë) nuk do të lë shkel e shko.

Pasi që kjo periudhë e paplotësuar e jetës së njeriut nuk mund të plotësohet dhe të dalë në shesh qëllimi i krijimit të tij, jashta se me jetën e ardhshme gjithçka ruan toka prej inçizimeve, patjetër të paraqitet herën tjetër (dytë).

Derisa emocionet e njeriut nuk njihen ndryshe, vetëm me atë çka ka përgatitur Krijuesi i tyre në botën e ardhshme, sepse ata janë krijuar për botën tjetër dhe se Ai i Cili fillon dhe përsërit e ka nisur krijimin për herë të parë është shumë lehtë për të që ta rikthejë atë herën tjetër. Ai i Cili ka caktuar vdekjen dhe jetën ka dërguar peygamberë të vërtetë duke i përmbajtur me argumente dhe dokumente që na kanë lajmëruar për mbarimin dhe dënimin e Zotit të Madhërueshëm gabimtarëve zjarrin si lëndë djegëse e të cilit janë njerëzit dhe gurët sikur që na ka lajmëruar për lumturinë e madhe në xhennet gjëresia e të cilit është qiejt dhe toka, po ashtu Muhammedi a.s. na ka lajmëruar se është peygamber i fundit dhe se llogaria është afruar, sikurse na ka lajmëruar për shenjat e afrimit të Kijametit të cilat do të ndodhin pas tij sikur që jeni duke i parë se kanë filluar të dalin në shesh. Një gjë e tillë ka qenë e pamundur që të besohet në kohërat e kaluara se do të ngjajë sikur të mos ishte ai që na ka lajmëruar për të Muhammedi a.s., inspiruar prej Zotit të Madhërueshem, pra, sot jemi duke dëshmuar ashtu sikur që na ka lajmëruar peygamberi a.s. kurse

nesër do t'i shohin pronarët e xhennemit, atë çka na ka premtuar Zoti sikur që do të shohin pronarët e xhennetit vërtetësinë e premtimit të Zotit të Madhërueshëm. Ja disa shenja për të cilat na ka lajmëruar pejgamberi s.a.v.s.:

1. Paraqitja e çudirave që nuk bijnë ndërmend:

Kjo është koha e çudirave në ndodhitë e jashtëzakonshme, fillet, moralet dhe rregullimet, koha në të cilën dëshmojmë ngjarje të mëdha për të cilat nuk na ka rënë ndërmend se do të ndodhin Pejgamberi s.a.v.s. ka lajmëruar për këtë kohë në mënyrë që të mos shqetësohen mendjet tona dhe të mos u bashkangjiten zemrat tona këtyre ngjarjeve të mëdha andaj pejgamberi s.a.v.s. ka thënë:

“Nuk bëhet Kijameti derisa të shihni ngjarje të mëdha të cilat nuk i keni parë e as që keni menduar ndonjëherë për ta. “(transmetojnë: Neimi i biri i Hammadit, Ahmed bin Hambeli, Bezzari dhe Taberani). Po ashtu pejgamberi a.s. ka thënë:

“Para se të ndodhë Kijameti do të shihni ngjarje të mëdha të cilat do t'i refuzoni (mohoni) duke thënë: a kemi biseduar për këta?! e kur t'i shihni ato gjëra përmendnie Zotin xh.sh. dhe dijeni se ata janë fillimi i kijametit”. (trans. Taberani dhe Bezzari).

2. Të vobektit e zhveshur, barinjtë mendjemëdhënjë ndërtojnë ndërtesa të medha:

Asnjë prej njerëzve ose injorantëve nuk beson për këtë çështje përveç besimtarëve se bariu i dhurve i zhveshur pa këpucë, tesha e pa ushqim do t'i vie rasti që të ndërtojë ndërtesa të mëdha dhe do t'i nxisë të tjerët për ndërtim, kur pamë nxjerrjen e naftës prej tokës, barinjve të zhveshur

mendjemëdhenjë duke e tepruar për ndërtim, për të cilën vërtetoi pejgamberi a.s. duke na lajmëruar për ndodhi para disa shekujve duke thenë:

“Kur të shihni të vobektit të zhveshur mendjemëdhenjë barinj të deleve duke tepruar në ndërtim, atëherë prite Kijametin.” (trans. Imam Buhariu dhe mam Muslimi)

3. Zbukurimi i shtëpive sikur që zbukurohen teshat:

Nuk ka pasur arsye që njerëzit të harxhojnë mundin e tyre në zbukurimin e mureve të shtëpive sikur që zbukurohen rrobet, gjë e cila shkakton angazhim në gjëra që janë të panevojshme derisa erdhi kjo kohë dhe pamë zbukurimet për të cilat na ka lajmëruar Muhammedi s.a.v.s. duke thënë:

“Nuk bëhet kijameti derisa të ndërtojnë njerëzit shtëpia duke i zbukuruar sikur zbukurim rrobesh.” (trans. Imam Buhariu)

4. Afrimi i pjesëve të tokës:

Askush nuk ka menduar se pjesët e tokës do të afrohen derisa shikuesi t’i shohë përnjëherë të gjitha pjesët e tokës të largëta, ashtu siç ka paralajmëruar pejgamberi a.s. duke thenë:

“Më është afruar mua toka dhe pashë lindjen dhe perëndimin e saj, ashtu do të arrijë sundimi i popullit (ummetit) tim aq sa me është treguar mua prej saj.”

Kështu pra, pejgamberi s.a.v.s. ka lajmëruar se në kohën e fundit do të afrohet toka, duke thenë për këtë gjë kështu:

“*Nuk bëhet kijameti derisa të shkurtobet koha dhe të afrohet toka.*” (Hadithet e lartpërmendura i transmeton Imam Buhariu në permbledhjen El Edeb El Mufred)

Këto distanca janë shkurtuar, kjo pra është prej afrimit të tokës dhe shkurtimit të kohës Këto janë prej shenjave të Kijametit ashtu sikur që ka treguar pejgamberi a.s. i cili është i vërtetë dhe i besueshem.

5. Të folurit e egërsirave, shprehja e gjërave të ngurta dhe transmetimi i lajmeve të gruas të burri i saj:

A mund të flasin egërsirat? Kjo ka qenë e pamundshme për ata të cilët kanë jetuar përpara nesh... Kurse sot gati është afruar koha që të flasin, sikur që është konstatuar se disa mace kanë filluar të flasin, derisa nesër do t'u bashkangjiten atyre edhe egërsirat. Pra, kjo është shenjë prej shenjave të kijametit, ashtu siç na ka lajmëruan Muhammedi s.a.v.s., kurse nesër do të ndodhë Kijameti sikur që kanë ndodhur sot disa shenja të tij.

Po ashtu nuk ka besuar askush përpara nesh se do të vijë koha që do të flasin gjërat e ngurta, ja sot jemi dëshmitar si p.sh.; radioja, televizioni etj. Sikur ka qenë e pabesueshme një gjë e tillë, se njeriu nëpërmjet një aparati të ngurtë do të mund të dijë se çka ndodhur në shtepi të tij kur ai gjendet në rrugë larg familjes së tij derisa hulumtuesit kanë mundur që të shpikin asi lloj aparati i cili ia transmeton lajmet njeriut kudo që të jetë nëpërmjet valëve kurse nesër ky aparat do të zhvillohet në forma të ndryshme që do të flasë sikurse radioja. Të gjitha këto që u lartpërmendën janë shenja të afrimit të Kijametit, pejgamberi a.s. ka thënë:

“Pasha Atë në dorën e të cilit është shpirti im, nuk bëhet kijameti derisa t'u flasin egërsirat njerëzve dhe derisa t'i folë njeriut kamxhiku dhe këpucët e tij duke e lajmëruar atë se çka ka ngjarë në familje pas tij.“ (trans. imam Ahmedi, Imam Tirmidhiu, imam Hakimi)

Kjo është të folurit e egërsirave dhe ngurtësive dhe krejt kjo është shenja e afrimit të Kijametit.

6. Renesancë shkencore me injorancë ndaj fesë:

Është konstatuar se kur shtohet leximi shtohet dija dhe kur shtohen princat shtohet sigurimi, por në kohët e fundit është duke ndodhur e kundërta ashtu sikur që na ka lajmëruar Muhammedi s.a.v.s.:

“Prej shenjave të afrimit të Kijametit duket se do të ketë shumë lexues e pak dijetarë dhe shumë kryetarë e pak siguri.” (trans. Imam Taberaniu)

Nuk ka dyshim se dituria ka qenë element për forcimjn e fesë dhe injoranca element i dobësimit të saj, por në kohën e fundit po ndodh e kundërta ashtu sikur që lajmëroi peygamberi a.s. dhe tha:

“Do të ketë në fund lutës injorantë dhe lexues mëkatar.” (Trans. Imarn Hakimi)

7. Shumimi i pasurive, tregtisë, leximit dhe shkrimit:

Pejgamberi a.s. ka thënë;

“Me të vërtetë prej shenjave të Kijametit është shtimi i pasurisë tregtisë dhe paraqitja e shkrimit.” (trans. Imam Nesaiu)

Pra, paraqitja e shkrimit është argument për shtimin e shkrimtarëve dhe lexuesve.

8. Zhveshja e grave, përhedhja dhe ngritja e kokave:

Nuk i ka rënë ndërmend askujt se gratë e muslimanëve do të zhveshen dhe përdridhen, dhe përdorimi i të gjitha mënyrave që i nxisin epshtet e meshkujve. Pra, elementi i zhveshjes është

duke u dëshmuar edhe pse rrobet mjaftojnë, siç janë rrobet e ngushta që gruan e bëjnë sikur është e zhveshur, rrobet e holla që ia tregojnë trupin ndër to... rrobet e shkurta që tregojnë një pjesë bukur të madhe të trupit të saj edhe pse basmat (stofet) dhe rrobet janë më se të teperta të cilat e mbulojnë ate çka duket, vendverimet e përziera detare ku duket gruaja e zhveshur lakuriq me përjashtim të organit të turpshëm dhe gjoksit të saj!! Shumica e grave kanë shprehi të veshin këpucë të larta që ia bëjnë trupin e thyer përmbropa me qëllim të bëhen sa më tërheqëse, të anojnë kokat dhe zemrat e të mashtruarve me gjithë zemrat dhe trupat e mashtruesëve si dhe me zhveshje dhe përdredhje të ndryshme, ashtu siç janë majet e shpinave të devës. Pra, këtë e ka zbuluar Muhammedi s.a.v.s. me fjalë të prera ashtu sikur të ishte i pranishëm në mesin tonë sot duke thënë:

“Dy lloj prej ummetit tim të cilët nuk i kam parë janë në zjarr, njëri lloj është populli i cili do të mbajë kamxhikun sikurse bishtat e lopëve duke rrahur njerëzit me të dhe lloji i dytë gratë e veshura-zhveshura përdredhëse, të thyera, kokat e tyre sikur majet e shpinave të deveve.” (trans. Imam Muslimi)

9. Ngjajshmëria (përgjasimi) e burrave me gratë dhe e grave me burrat:

Askujt prej të parëve nuk i ka shkuar ndërmend se burrat do t'u përngjajnë grave dhe e kundërta për të cilën Muhammedi s.a.v.s. ka lajmëruar se “*Prej shenjave të afrimit të Kijametit është ngjajshmëria (përgjasimi) e burrave me gratë dhe e grave me burrat.*” (trans. Ebu Neimi)

10. Edukimi i qenëve, urrejtja e edukimit të fëmijëve dhe përhapja e aventurizmit:

Askush nuk ka paramenduar se do të vijë koha kur njerëzit do të urrejnë edukimin e fëmijëve të tyre, duke u kthyer në edukimin e qenëve, e sidomos në ambientin e familjeve arabe që krenohen me numrin e madh të djemëve të tyre.

Mirëpo ky është pejgamberizmi nëpërmjet të cilit Zoti xh.sh. i ka zbuluar perdet e kohës pejgamberit të Tij duke e lajmëruar atë se ajo është prej shenjave të kohës së fundit, andaj pejgamberi a.s. ka thënë:

“Kur do të afrohet Kijameti do të jetë më mirë për njeriun të edukojë një qen (të vogël) se sa të edukoj fëmijën e vet, nuk do të nderohet i madhi e as që do të mëshirohet i vogli do të shtohen fëmijët e aventurave derisa burri do të çnderon femrën në një skaj të rrugës, do t’i veshin lëkurat e dhive me zemër të ujqve, shembulli më i mirë i tyre do të jetë më dinaku (dhëlpëra).“ (trans. 1n Taberanj dhe Imam Hakimi)

Këto janë disa shenja që jemi duke i dëshmuar për të cilat na kanë lajmëruar hadithet (thëniet) e Muhammedit s.a.v.s., para se të ngjajnë me disa shekuj i kemi parë ata ashtu sikur që na ka lajmëruar. Është ai që na ka treguar për Kijametin, çështjen dhe gjendjen e tij gjë e cila e nxit të mençurin dhe e shpie që të mendojë për mbarimin e tij për të cilin atë e kanë lajmëruar pejgamberët e ndershem, po ashtu atë do ta shpijë të mendojë për çështjen e kësaj bote në të cilën jeton.

BOTA DHE VERTETËSIA E SAJ - E VERTETA

Nëse thellohesh pak në atë çka ka kaluar prej jetës tënde, do ta dish vlerën e kësaj bote, sepse pasi që ke ardhur deri te momenti i paravdekjes të është kujtuar jeta e cila ka mbaruar me prezentimin e vdekjes, atëherë do ta dishë se ti në këtë botë ke qenë vetëm se një udhëtar, ashtu sikur që ka lajmëruar pejgambeni a.s. duke thënë: *“Jeto në këtë botë sikur me qenë i huaj ose udhëtar”*.

Pra, o ti udhëtar a ke përgatitur çka të nevojitet për shtëpinë e përhershme? Apo je nxënur me të tubuarit e gjërave të kota, duke lënë pas dore gjërat e nevojshme të cilat do të duhen nesër?... Pyete vetën në realitet cilat janë ato gjëra nga të cilat do të keshë dobi prej tyre dhe për të cilat vrapon pas tyre? Pra, nuk është për ty asgjë tjetër vetëm ajo çka ke ngrënë dhe ke harxhuar, ke veshur dhe shkatërruar dhe ke dhënë e ke shkuar, do të dalësh nga kjo botë duke e lënë çdo gjë. Sikur të ktheheshin krejt ata të cilët kanë jetuar përpara neve në këtë tokë do të shihnim me mijëra njerëz që do të grindeshin dhe përlesheshin për një copë toke dhe secili prej tyre do të supozonte se ai e ka punuar dhe sunduar atë dhe se ajo cope tokë ka qenë pasuri e tij! Pra, kush është sunduesi i vërtetë. Zoti Madhëruar në Kur’an thotë:

“Ne vërtetë jemi që japim jetë e vdekje dhe Ne jemi trashëgues (të qiejve e tokës). S’ka dyshim se Ne e dijmë për ata qofshin para jush dhe edhe për ata që vijnë pas. E Zoti yt është Ai që i tubon të gjithë (të kaluarit e të ardhshmit), vërtetë Ai është shumë i urtë, shumë i dijsëm.” (Hixhr:23-25)

Sikur të mendosh shumë në jetën tënde, do të njohësh Zotin tënd dhe peygamberin e Tij, atëherë do të dish se kjo botë nuk është kurgjë tjetër vetëm vend provimi dhe goditjesh, provohen në të njerëzit në mënyrë që të dallohet respektuesi (ai që respekton) prej kundërshtarit, pastaj do të dalin prej saj sikur që kanë ardhur në të, All-llahu xh.sh. thotë:

“Në të vërtetë ju na erdhët një nga një (të vetmuar), ashtu si ju krijuam së pari keni lenë prapa shpinës atë që u patëm dhënë...” (En’am: 94)

Sikur ta njohësh ahiretin (botën e ardhshme) dhe vërtetësinë e tij, do ta dije dhe do të përmalloheshe për jetën në të dhe do ta shpëtoje vetën prej rreziqeve të tij.

BOTA E ARDHSHME

Pasi që kjo botë ishte ditë të kaluara, atëherë bota e ardhshme (ahireti) është jetë e përhershme dhe e pambarim. Nëse kjo botë është vend i lodhjeve, mundimeve dhe fatkeqësive, atëherë bota e ardhshme (ahireti) është vend i kënaqësive, lumturive dhe dëfrimeve, sikur që thotë All-llahu xh.sh. në Kur’an;

“Ndërsa besimtarëve të ruajtur xhenneti u afrohet krejt afër. Kjo është ajo që u premtohet për secilin që pendohet dhe që e ruan besën e dhënë. Për secilin që i është frikësuar Zotit pa e parë dhe ka qenë i kthyer tek Ai me zemër të sinqertë. (U thuhet) Hyni në të. Të shpëtuar, se kjo është dita e përjetshme. Ata aty kanë çka të dëshirojnë, e te Ne ka edhe më shumë.” (Kaf: 31-35)

Kurse për ata të cilët nuk besojnë në Zotin e tyre ka denim të madh dhe kur do të dalin përpara Zotit do të lypin prej Tij që t'i kthejë përsëri në këtë botë që të punojnë punë të mira e jo ashtu siç kanë punuar herën e parë.

All-llahu i madhërueshëm do t'ua kthejë duke u thenë atyre se juve u është dhënë kohë e mjaftueshme që të kujtoheni, gjithashtu u ka dërguar vërejtës, mirëpo ata nuk i janë frikuar ditës në të cilën nuk ka ndihmës tjetër përveç All-llahut.

“Po për ata që nuk besuan është zjarri i xhehennemit. Ata as nuk gjykohen që të vdesin (të rehatohen) e as nuk u lehtësohet ndëshkimi. Kështu e ndëshkojmë secilin që është shumë i pabesim. Dhe ata do të klithin aty: “O Zoti ynë nxirrna e të bëjmë vepra të mira, e jo si ato që bënim!< Po a nuk u dhanë juve jetë aq sa që ai që ka dashur të mendojë ka mundur të mendojë gjatë asaj kohe, madje juve u ka ardhur edhe peygamberi, pra, shijoni, se për zullumqarët nuk ka ndonjë ndihmëtar.“ (Fatir: 36-37)

BESIMI ËSHTË RRUGA E PUNËS PËR SHPËTIM

Por ti o i mençur nuk mund ta arrish shpëtimin e vërtetë dhe të përhershëm te Zoti i madhërueshëm, po ashtu nuk mund të mbledhësh atë që të nevojitet për shpëtim nga dënimi i dhembshëm në botën kah e cila shkon çdo ditë vetëm nëse je besimtar i vërtetë duke dalë nga dyshimi i të luhaturve ndaj të cilëve ka thënë All-llahu xh.sh.:

“Edhe kur u thuhej se premtimi i All-llahut është i saktë dhe se do të vijë kijameti për të cilin s’ka dyshim, ju thatë: ‘Ne nuk dijmë se ç’është kijameti, ne me dyshim menduam për të...’” (Xhathije: 32)

Andaj pra, patjetër duhet besim... dhe patjetër të ketë argumente mbi të cilat ndërtohet besimi... sa më të shumta janë këto argumente, mirëpo ku janë të mençurit dhe ku janë pronarët e zemrave të shëndosha.

DITURIA ËSHTË RRUGA E BESIMIT

Kur të vërtetohet njeriu se çështje më me rëndësi në këtë ekzistencë-jetë, është që ta njohë Zotin dhe peygamberin e Tij dhe se ajo është rruga e lumturisë në këtë botë dhe në botën tjetër. Andaj, patjetër i nevojitet të nxit për njohjen e argumenteve të besimit dhe dokumentet e tij, sepse Zoti i madhërueshem e ka bërë diturinë rrugë të besimit në Zotin duke thënë:

“Atëherë, dije se nuk ka Zot tjetër pos All-llahut...” (Muhammed; 19).

Po ashtu All-llahu xhel-le shanuhu thotë:

“A është i nejtë ai që e di se ajo që t’u shpall ty nga Zoti yt është e vërtetë si ai që është i verbër? Vetëm njerëzit e arsyeshëm që kanë mendje të shëndoshë e kuptojnë te vërtetën.” (Rra’d: 19).

RREZIKU I IMITIMIT NË BESIM

Zoti i madhërueshëm ka sqaruar se imitimi i prindërve pa dije është prej cilësive me të urrejtura për të cilën edhe i ka qortuar pabesimtarët duke thënë:

“E kur u thuhet atyre (idhujtareve): ‘Pranoni atë që All-llahu e shpalli!’ ata thonë: ‘ne ndjekim atë në të cilën i gjetëm prindërit tanë’ ‘Edhe sikur prindërit e tyre të mos kenë kuptuar asgjë dhe të mos jenë udhëzuar në rrugën e drejtë (ata do t’i pasonin)?” (Bekare: 170)

Po ashtu ka sqaruar se rruga për besimin që i është zbritur Muhammedit a.s. është dija dhe se ai i cili nuk di për besimin e vet është i verbër dhe se i verbëri mund të drejtohet në çdo anë nga çdokush. Prandaj është lehtë për muslimanin imitues të verbër në besimin e tij që t’i përgjigjet çfarëdo thirrjeje dhe çfarëdo ideje, sepse ai është i verbër dhe me ndërtimin e besimit në imitim e humb vërtetësinë e besimit dhe dritën e tij. Prandaj kjo gjë i ka mbrapshtuar punët e imituesve prej muslimanëve, duke adhuruar Zotin e madhërueshëm me padije, duke e praktikuar një pjesë të Islamit dhe duke u larguar nga pjesët tjera sepse iu dukën rendë ose janë të luhatshëm në besimin e tyre All-llahu xh.sh. thotë:

“Ka nga njerëzit që adhuron All-llahun me mëdyshje (luhatshëm) nëse e godet ndonjë e mirë ai qetësohet me të, po nëse e godet ndonjë e pakëndshme, ai kthehet në fytyrën e vet të vërtetë (të meparshme) ai i ka humbur këtë dhe jetën tjetër ky është ai dështimë i qartë.” (Haxh: 11)

Ky besim i imituar nuk qëndron përpara fjalëve të dyshimtarëve e sidomos në këtë kohë, në të cilën janë paraqitur lloj-lloj shpifjesh, nga të cilat nuk shpëton jashta ai i cili e njeh fenë e vet,

sikur që jemi lajmëfiar nga peygamberi a.s. i cili thotë se: *“Do të ndodhin shpifje nga të cilat nuk shpëton askush jashta atij që e njëh jenë e vet!”*

BESIMI ËSHTË RRUGA E LUMTURISË (DHE SHTOHET ME PUNË TË MIRA)

Kush dëshiron për vete lumturi dhe shpëtim për njerëzinë le t’i përmbahet besimit... dhe kush dëshiron jetë dhe punë të mira në këtë botë le t’i përmbahet besimit se puna e mirë është fryt prej fryteve të besimit.

Kush dëshiron lumturi në botën tjetër dhe shpëtim prej dënimit le t’i përmbahet besimit. Kush arrin besimin në bazë të dijes dhe njohurisë, që ta mbrojë dhe zhvilloj atë duhet të punojë punë të mira sepse besimi: “Shtohet me respektim dhe pakësohet me kundërshtim”, ashtu sikur që na ka udhëzuar peygamberi a.s.

CIVILIZIMI NË NGUSHTICË (KURSE RRUGËDALJA E TIJ ËSHTË BESIMI NË ZOTIN XH.SH.)

Njeriu sot është duke jetuar nën hijen e civilizimit joislam, i humbur duke mos gjetur kuptimin e domethënies për jetën e tij. Ka mësuar prej civilizimit të sotshëm si të jetojë, kurse ai (civilizimi) nuk i tregon askujt përse është krijuar dhe pse jeton? Pra, shembulli i civilizimit bashkëkohor është sikurse një njeri që ka ndërtuar një anije dhe e ka përsosur atë duke e zbukuruar, pastaj i thirr njerëzit të hypin në të (duke ngritur zërin e tij për tërheqjen e udhëtarëve) duke ua shpjeguar të gjitha kënaqësitë gjatë udhëtimit, çka ka përgatitur për udhëtarët, çka do të hanë, çka do të pinë, ku do të flejnë, ku do ta kalojnë kohën me të gjitha llojet e dëfrimit. Mirëpo njëri e pyeti për ku shkon kjo anije? I zoti i saj tha: nuk e di?!

Kështu është edhe shembulli i civilizimit të sotshëm që e meson njeriun si të jetojë, kurse nga ana tjetër nuk e di pse jeton! dhe çfarë kuptimi ka qenja e tij. Andaj nuk ka rrugëdalje prej kësaj humbje në këtë botë, vetëm me kthimin tonë te Krijuesi jonë sepse Ai është i vetmi, i cili e di pse i ka krijuar njerëzit.

All-llahu xh.sh. i ka krijuar njerëzit për domethënie (hikmet) të cilën e ka ruajtur në vetvete dhe i krijuari nuk mund ta dijë se çka ka në vetën e Krijuesit, sikur që ka thënë All-llahu xh.sh. në Kur'an:

“...Ti e di ç’ka në mua, e unë nuk di ç’ka në Ty...” (Majde: 116).

Derisa njeriu nuk e din krijuesin e tij dhe mbetet në shikimin e Zotit më i pavlefshëm se gjethet dhe rrënjet e pemëve.

Po ashtu prej veçorive të civilizimit bashkëkohor është josiguria, frika, e cila rrezikon jetën personale dhe atë shoqërore dhe e cila shpie në vetëvrasje, ose në përdorjen e opiumeve, ose të përdorimit të metodave të çmendura, të cilat i mbushin trupat e njerëzve tërë frikë. Shkaku i kësaj frike është humbja e sigurisë dhe rehatisë në jetën të cilën e jeton njeriu, sepse çdo gjë që vepron me të njeriu nuk është në rrethën e posedimit të tij të vërtetë, sepse ai nuk mund të krijojë gjë, kurse në anën tjetër nuk e din sunduesin e vërtetë.. Gjithashtu vdekja e cila e befason atë ia prish dhe shkatërron të gjitha shpresat, duke e shpërngulur atë në jetën e panjohur (është fjala për pabesimtarin) dhe gjendja e tij është sikur një njeri të cilin e detyron ndokush të flejë në rrugë ku kalojnë automjetet!!.

Pasqyra e këtyre ndryshimeve janë mendimet dhe drejtimit në mes njerëzve të cilëve nuk mund t'u shmanget derisa njerëzit jetojnë larg rrugës së Zotit xh.sh. dhe nuk ka rrugëdalje jashta se me besim. Gjithashtu gjetja e përlshjes në mes njerëzve është fryt prej frytave të kufrit dhe nuk ka rrugëdalje jashta se me besim.

Dallimi i civilizimit të sotëm prej civilizimeve të mëparshme është se ky civilizim veçohet me mizori dhe shfrytëzim, ngase sunduesit apo ligdhënësit nxjerrin ligje që janë në favor personal, njësoj si në parlamentin demokratik ashtu edhe në qendrat partiake, duke i bërë ato ligje shërbyes të intertesave personale të cilat ua sigurojnë atyre plotësimin e dëshirave epshore. Shembull konkret kemi amerikanët të cilët luftojnë për mbrojtjen e interesave imperialiste (kapitaliste) që dinë shumë mirë si të korrin sukses në zgjedhjet parlamentare. Nga ana tjetër, populli rus,

angazhohet me të gjithë forcat e veta për mbrojtjen e interesave të qendrës, udhëheqësisë së partisë komuniste dhe personave të partisë të cilat posedojnë për vete të drejta speciale, duke e ditur se çfarë rruge duhet ndjekur për nënshtrimin e njerëzve dhe duke i detyruar ata që të okupohen me perde prej hekuri.

Pra, në bazë të këtyre dy shembujve konkrete maten (bazohen) edhe vendet tjera pabesimtare, dhe as që mund të zhduket kjo mizori dhe ky shfrytëzim që janë duke i praktikuar sundimtarët e sotëm, deri sa t'u merret sundimi prej duarve të tyre. I vetmi ligj i drejtë dhe i përshtatshëm është ligji i All-llahut xh.sh., i cili nuk anon nga asnjë racë apo parti, komb apo grup, ndërsa njeriu është përplot anime, egoizma dhe dëshira epshore të cilat është rëndë t'i ndërrohen atij, kurse me lehtë është t'i hiqet sundimi prej duarve të tij, dhe t'ia afrosh Krijuesit i cili nuk bën mizori.

Sa i përket sheriatit Islam (sheriatit të All-llahut xh.sh.) drejtësisë dhe përqëndrimit të Tij është e qartë, ngase këtë gjë e kanë dëshmuar juristë jomuslimanë, të cilët kanë qenë të drejtë në fjalën e tyre, nuk kanë pasur nga t'ia mbajnë, veç se të deshmojnë për drejtësinë e sheriatit ashtu sikur e kanë ditur. Dëshmia e këtyre pabesimtarëve është ajo e cila ua bën popujve të tyre me dije se nuk ka rrugëdalje tjetër për ta nga ngushtica e epsheve, interesave, injorancave dhe amoraliteteve jashta ndjekjes së sheriatit Islam.

Po ashtu dëshmia e këtyre juristëve jomusliman është argument i fortë ndaj atyre muslimanëve të cilët nuk e praktikojnë sheriatin Islam mes veti.

Para se të përfundojmë ja disa fjale te tyre:

1.) Profesorj i drejtësisë në Universitetin e Harvardit në librin e tij me titull “Shpirti i politikës botërore” botuar ne v. 1932 thotë:

“Sa i përket përparimit të Sunduesve Islamë nuk i përngjet Perëndimit i cili ka ndjekur metoda duke supozuar se feja nuk ka të drejtë të thotë asgjë për jetën e përditshme të personave. Kurse sa i përket zakonisht dhe ligjeve qiellore, njeriu në fe patjetër duhet të gjejë burim për zhvillim dhe përparim, dhe disa herë pyesin dikush se a mund të lindë rregulli Islam dispozita të tjera dhe të pavarura, të cilat pajtohen mes veti dhe të cilat i kërkon jeta bashkëkohore?”

Përgjigja ndaj kësaj pyetjeje është: Në të vërtetë rregulli Islam me të gjitha gatishmëritë e brendshme nxit zhvillim dhe përparim, por edhe me interesant është se ai ka kapacitet për përparim, i cili dallohet shumë nga rregullat e ngjashme. Nga e tërë kjo kuptohet se nuk ka qenë problemi i mospasjës së metodave për zhvillim dhe ngritje në shariat Islam, por problemi ka qëndruar se përfaqesuesit e Islamit gjithmonë kanë shkuar nga ajo që të mos i përdorin këto metoda, andaj unë e ndjej vetën se jam i drejtë atëherë kur konstatoj se shariati Islam i përfshinë fillet e nevojshme për zhvillim e përparim.”

2.) Shtreli-dekan i fakultetit të drejtësisë ne Universitetin e Vjenës, në Kongresin e juristëve në vitin 1927 thotë:

“Në të vërtetë njerëzit krenohen me qenien e një njeriut si Muhammedi, sepse ai me gjithë analfabetizmin e tij ka mundur të nxjerrë një ligj para 13 shekujve për të cilin ne evropianët do të jemi më të lumtur në rast se arrijmë kulminacionin e tij pas 2000 vitesh.”

3.) Ndërsa Kongresi Internacional i mbajtur në Lahaj në gusht të vitit 1937 mori vendim:

“1. Sheriati Islam të konsiderohet si bazë prej bazave të ligjeve botërore d.m.th. se sheriatit Islam është bërë bazë e gjyqeve dhe ligjeve botërore, jo pse muslimanët konsiderohen si fuqi, por për përshtatshmërinë dhe fuqinë e tij që i detyron njerëzit për përdorjen e tij.

2. Kongresi shpalli se sheriatit Islam është i vetqëndrueshem dhe i pavarur nga ligjet tjera.”

4.) Sa i përket javës së Fikhut Islam mbajtur në Paris në vitin 1952, duke u ngritur kryetari i avokatëve francezë ka thënë:

“Nuk e di si do të mund të bëj pëlqim mes asaj që na është treguar neve (nga ana e orientalistëve) për ngurtësinë dhe konservatizmin e sheriatit dhe Fikhut Islam dhe mospërshtatshmërisë së tyre si bazë e ligjeve përparimtare dhe mes asaj që degjova (prej dijetarëve islamë) e cila vërtetohet pa dyshim se ndikimi i sheriatit islam, thellësia rrënjët, përpikshmëria, gjithanshmëria dhe përshtatshmëria është në gjendje që t’u përballojë të gjitha ndodhjet”

5.) Shoqata e zakoneve botërore e ka konsideruar Muhammed ibn Hasen Esh-Shejbanin shokun e Ebu Hanifes si shpikës i parë i ligjeve botërore.

Pas të gjitha këtyre që dëgjuam çfarë do të jetë vlerësimi yt si i mençur nëse e sheh se një grup njerëzish në një shtet i kanë shndërruar veturat për lëvizim e lëvizuesit i kanë shndërruar për stilizim a do të kesh dyshim ti si i mençur në çmendjen e këtyre njerëzve pasi që e pe se çka kanë punuar?! Të njëjtën gjë e ka bërë njeriu në ditën e sotme, i ka shndërruar njerëzit dhe i ka bërë burrat gra e gratë burra. Çudi e madhe pasi që njeriu Zotit i madhërueshëm e ka bërë fisnik, shndërrohet në lloj kafshe që nuk ka kurrfarë bukurie e as estetike, duke e prishur rregullin e familjes dhe moralit. Këto gjera dhe shumë të tjera janë katastrofat e ngushticave të civilizimit të

sotëm. Nuk ka dyshim se krejt kjo është fryti i kufrit i cili është përzier me humbje, frikë, mospajtim, përleshje mizori, shfrytezim, prishje dhe dekadencia te ndryshme. Andaj patjetër duhet pasur besim në menyrë që të shpëtojnë muslimanët nga këto semundje, me të cilat janë goditur në besimin e tyre para se të goditen në trupat e tyre dhe për shpëtimin e pabesimtarëve (kufarëve) prej këtyre ngushticave në të cilat i ka shtyrë kufri ata. Patjetër duhet pasur besim (të fortë) sepse ajo është detyrë e domosdoshme për muslimanët dhe trashëguesit e pejgamberëve.

“Zoti ynë ne dëgjua një thirrës që ftonte për besim (e që thonte): të besoni Zotin tuaj! e ne besuam “. (Ali Imran: 193)

AI I CILI IA KA DHËNË ÇDO GJËJE KRIJIMIN E VET, PASTAJ E KA UDHËZUAR (ATË)

Nëse ti thellohesh pak në krijimin tënd (se si je krijuar), do ta gjesësh se çdo pjesë të trupit tënd e ka krijuar Zoti i Madhërisëm me qëllim të caktuar. E ka bërë atë krijim të përshtatshëm me realizimin e qëllimit (maturie) dhe detyrës për të cilat është krijuar (njeriu).

Thellohu pak në krijimin e syve, veshëve dhe lukthit se si janë të përshtatshëm secila prej tyre me detyrën që kryejnë dhe se si ti i Madhëruar i ka udhëzuar ata dhe ia ka bërë të mundshme që ta kryejnë detyrën e tyre me sukses, andaj; syri shikon, veshi dëgjon dhe lukthi e përpunon ushqimin, kurse të gjitha këto janë të krijuara prej një materie.

Gjithashtu mendo pak për krijimin e pemës së shëgës, për mbjelljen e grurit dhe për pemën e hurmës, se si i ka caktuar Zoti i gjithëfuqishëm secilës prej tyre krijim të posaçëm dhe frut të vacantë. E ka drejtuar secilën prej tyre se si ta formojë frutin e saj në mënyrë të vacantë, të marrë formën e vet të kufizuar, gjethet, kërcyellin dhe frutet, kurse të gjitha

këto janë të krijuara prej të njejtës materie. All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

“E në tokë, copa sipërfaqesh, të ngjitura njëra me tjetrën, kopshte të hardhisë, të mbjella (të lloj llojshme,) dhe hurma (bimë këto që janë të degëzuara në shumë trupa dhe jo të degëzuara (nga një filiz), e të gjitha ujiten nga një ujë dhe Ne shijen në ngrënie të frutave të tyre e kemi dalluar njërën prej tjetrës. Edhe kjo dëshmon me argumente për njerëzit e mençur.“ (Rra'd: 4)

Mendo në ndryshimin e jetës së peshqve, shpezëve, mizave, mikrobeve dhe të gjitha llojeve të kafshëve, se si i ka krijuar ata Zoti xh.sh. prej një materiali dhe ua ka caktuar atyre që të jetojnë në vende të ndryshme dhe secila prej këtyre jeton në menyrë të ndryshme. Mirëpo Zoti fuqiplotë e ka drejtuar çdo krijesë që të jetojë në atë mënyrë ashtu sikur që i përshtatet asaj dhe i përshtatet jetës së saj. E ka udhëzuar çdo pjesë në të që ta kryejë detyren e vet p.sh. i ka bërë fletët që t'i bartin shpezët, veshëzat e peshkut që ta filtrojnë ajrin nga uji etj. All-llahu xh.sh. thotë:

“All-llahu krijoi secilën gjallesë prej një uji e prej tyre ka që ecin rrëshqitas në barkun e vet, ka që ecin në të dy këmbët e edhe asosh që ecin në të katër këmbët. All-llahu krijon çka të dojë, pse vërtetë All-llahu ka mundësi për çdo gjë.“ (Nur: 45)

Pra, nëse mendon pak për diellin, hënën, planetet dhe yjet do të shohë se çdonjera prej tyre është krijuar me planifikim dhe caktim të posaçëm dhe është udhëzuar (nga Zoti) çdonjera prej tyre në

vendin e vet të posaçëm dhe të përshtatshëm Duke ia vizatuar çdonjerës prej tyre rrugën e udhëtimit dhe lundrimit të matur dhe të përputhur me caktimet (kaderet) dhe gjendjet e tyre, kështu me caktimin e Zotit, planifikimin dhe precizitetin e Tij, çdo gjë në gjithësi ka marrë drejtpeshimin e vet. All-llahu xh.sh. thotë:

“All-llahu i mban qiejt e tokën që të mos zhduken e nëse ato zhduken, s’ka kush pos Tij që mund t’i mbajë; Ai është që nuk ngutet, është që falë.” (Fatir: 41)

Andaj nëse ndodh që të shmanget një planet ose një yll apo Dielli ose Hëna nga vendqarkullimi i vet do të prishej tërë rregulli i Kosmosit në përgjithësi.

Pra, kush mendon dhe thellohet në këtë gjithësi do të dinë se Krijuesi i cili e ka shpikur krijimin e çdo gjëje, e ka udhëzuar secilën krijesë nga ajo që i është caktuar asaj.

All-llahu i Madhërisëm thotë:

“Madhëroje larg të metave Zotin tënd, më të lartësuarin i cili krijoj dhe porsosi. Dhe i cili përcaktoi dhe orientoi.” (A’ëla: 1-3)

RRUGA E BESIMIT

Nëse e studiojmë çështjen e njeriut, gjejmë se krijuesi i tij i ka dhënë fuqi diturie dhe dallimi në nënyrë që ta dallojë të mirën nga e keqja, të vërtetën nga e pavërteta dhe dobinë nga humbja (dëmi). Atij (njeriut) i ka krijuar mjete me të cilat i realizon dëshirat e tij, me të cilat e përfiton

diturinë dhe me të cilat e dallon të vërtetën nga e pavërteta. Andaj nëse atij i intereson e vërteta dhe do ta mbrojë atë duke e përcjellë shpëton dhe ka dobi prej saj, ndërsa nëse nuk i intereson e vërteta, duke e futur në harresë atë dhe duke e kundërshtuar atë pëson humbje të madhe. All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

“Ne e krijuam njeriun prej një uji të bashkëdyzuar për ta sprovuar atë andaj e bëmë të dëgjoj e të shohë. Ne e udhëzuam atë në rrugë të drejtë e ai do të jetë: mirënjohës ose përbuzës. Ne për jobesimtarët kemi përgatitur zinxhirë pranga e zjarr. S’ka dyshim se të devotshmit do të pljnë nga gota që përzierja brenda saj është nga kafuri (aromatik).” (Insan: 2-5)

“All-llahu ju nxori nga barqet e nënave tuaja (si foshnje) qo nuk dinit asgjë. Ju pajisi me (shqisa për) të dëgjuar me të parë dhe me zemër, ashtu që të jeni falënderues.” (Nahl: 78)

Pasi që All-llahu i Madhërisëm ia caktoi njeriut që të jetë i mençur, dallues, i ditur dhe zgjedhës, duke ia dhënë atij mjetet e diturisë dhe dallimit, e urdhëroj atë që ta ndjekë rrugën e diturisë dhe t’i përdorë mjetet të cilat ia ka krijuar atij dhe mos ta ndjekë një çështje ndaj të cilës nuk di asgjë dhe se ai do të jetë përgjegjës për (shmangjen) rrugën e shtrembërt të cilën e ndjek. Pasi që Zoti i Madhërisëm i’a krijoj atij të gjitha mundesitë për dije, studim dhe dallimin e së mirës nga e keqja. Zoti xh.sh. ka thenë:

“Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të pamurit dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi.” (Isra: 36)

Andaj nuk ka kurrfarë arsytjmi për njeriun nëse pas krejt kësaj që u përmend e ndjek rrugën e humbjes dhe nëse bëhet kokëfortë e nuk do të pranojë se ka Zot, ditën e gjykimit do të

mundohet të arsyetojë qendrimin e vet që e ka pasur në këtë botë, mirëpo vallë a do t'u pranohen atyre arsyetimet? All-llahu xh.sh. thotë;

“E atë ditë për ata që bënë zullum, arsyetimi nuk u bën dobi e as që kërkohet prej tyre justifikohen.” (Rrum: 57).

DIJE SE AI ËSHTË QË NUK KA ZOT TJETËR PËRVEÇ ALL-LLAHUT

Nëse Krijuesi yt është Ai i cili ta ka dhënë syrin duke qenë ti copë e vogël e përbërë prej mishit dhe gjakut në barkun e nënës tënde, duke të krijuar ty aparat për arritjen e dritës (syrin), derisa ti ke qenë në errësirë në barkun e nënës tënde dhe ta ka bërë të mundshme që me këtë mjet të shohësh afër ose larg, të dallosh gjërat prej njëra-tjetrës rreth teje, të ecish kah të duash vet në fytyrën e tokës, i sheh kush vjen dhe shkon, kontrollon gjithçka që del prej teje dhe çdo gjë që të bjen ndër sy ti e dëshmon atë. Në qoftëse është Krijuesi yt Ai i cili ta ka dhënë ty të dëgjuarit (veshin) për zërat, kurse ti duke qenë në botën e heshtjes në bark të nënës sate, ta dha ty aparatin e të dëgjuarit i matur dhe preciz me të cilin e njeh zërin e atij i cili të flet ose thërret, e merr vesh tjetrin se çka don prej teje, mëson prej tjetrit çka nuk ke ditur, në këtë aparat (veshin e njeriut) mund t'i flasë tjetrit dhe të kuptohen mes vete se secili prej tyre çka do prej tjetrit dhe të gjithë zërat i dallon me këtë aparat qofshin zëra krijesash apo mjetes të lloj-llojshëm.

Nëse Krijuesi yt i Madhërishtëm është Ai i cili ta ka dhënë fuqinë e të menduarit, kuptuarit, arritjes dhe dallimit mes të mirës dhe të keqës, dëmit dhe dobisë, duke u dalluar me zemrën (që i arrin të gjitha gjërat) nga kafshët të cilat njëlloj sikur ti kanë të dëgjuarit dhe të pamurit, duke e vendosur Zoti në ty këtë zemër dalluese munde që të dish se kush të sjell dëm e kush të sjell dobi. Për shkak kësaj Zoti xh.sh. ia ka nështruar njeriut kodrat, detërat, bimët, kafshët duke ecur skajeve të tokës duke notuar fundeve të detërave, duke fluturuar në atmosferë, duke përmirësuar jetën në këtë botë, duke e lypur atë që ke dobi prej saj, duke ua prishur jetën armiqve tuaj dhe duke ua drejtuar atyre atë çka i dëmton ato. Pra, krejt këto gjëra bëhen nëpërmjet zemrës të cilën Zoti i Madhërishtëm e ka bërë të kuptueshme ejo si zemrat e kafshëve dhe shtazëve. Andaj pa këtë zemër te mençur do të jesh në botën e të çmendurve, e që nuk vjen parasysh të ndërtosh ndonjë mjet për lehtësimin e jetës ose të shpikish ndonjë gjë të re sikur që shpikin njerëzjt lloj-lloj shpikjesh, ose të ndërtosh ndërtesa apo ta mbjellish tokën. Atëherë është shumë lehtë për njeriun që ta njohë Zotin e vet të Cilit i takon adhurimi, Ai është Krijuesi i vet dhe di çdo gjë të madhe ose të vogël, të hapur apo të fshehtë dhe di gjithçka që mban njeriu në zemrën e tij.

Nëse ti si njeri pak e përpunon mendjen tënde dhe thellohesh në rezultatin e jetës tënde se si do të ishte në rast se ti do të ishe pa sy, pa veshë dhe pa zemër që mendon, do të shihje se sa i pafuqjshëm do të ishe sa që nuk do të dije ta shpërngulesh vetën tënde në vend që të përshtatet ty, s'mund ta gjejsh ushqimin dhe ujin tënd, po ashtu nuk do të mund ta mbrosh vetvetën nga rreziku sa do që i vogël të jetë ai, qoftë prej njeriu apo prej ndonjë kafshe (egërsire), atëherë në këso gjendje vdekja do të ishte për ty më e dashur se kjo jetë e verbër, e shurdhër dhe e çmendur.

Pra, nëse është puna kështu, atëherë a nuk e sheh se si obligim të parë e ke ti që t'i përdorish këto mjete të cilat i ka krijuar All-llahu xh.sh. për ty, në mënyrë që të dishë atë që nuk e ke ditur -

në njohjen e Zotit dhe peygamberit të Tij. Të njohtohesh me dashjen e Atij që të ka krijuar dhe gjetur ty. Sikur që Zoti xh.sh. të mos të kishte dhënë ty të dëgjuarit, të parët dhe të kuptuarit, nuk do të kishte mundur askush prej njerëzve, idhujt dhe zotërat e ndryshëm të cilët i ke respektuar që të të japin sy, veshë apo zemër që të shohësh, ndjesh dhe kuptosh. All-llahu xh.sh. ka thënë në Kur'anin famëlartë:

“Thuaj: Nëse All-llahu ua merr të dëgjuarit, të pamurit dhe ua mbyll zemrat, pos All-llahut cili zot tjetër do t’ju sjellë atë. Shih se si ia sqarojmë faktet e megjithëkëtë ata nuk ua vënë veshin!” (En’am: 46)

Kështu pra, e sheh i mençuri se për obligim të parë e ka që t’i përdorë dhe shfrytëzojë mjetet e njohurisë, të cilat ia ka dhënë atij Krijuesi i tij që t’i përdorë në:

njohjen (diturinë) e urdhërit të Zotit të madhërishëm, njohjen ku është i kënaqur Ai dhe njohjen me çka ka ardhur me të peygamberi i Tij te ai. Zoti xh.sh. thotë:

“...Përkujtonie (me namaz) All-llahun ashtu si u mesoi Ai për atë që ju nuk dinit.” (Bekare: 239)

Me këtë mund të jemi në grupin e respektuesve dhe falënderuesve për të cilët All-llahu xh.sh. ka thënë:

“(Engjëjt) Thanë: ‘i pa të meta, ne nuk kemi dije tjetër përveç atë që na e mësove Ti. Vërtetë Ti je i gjithëdijshmi i urti!’” (Bekare: 32)

Njëlloj sikur që e sheh i mençurj se detyrë të parë e ka që ta realizojë urdhërnj e Zotit të tij i Cili ka thënë:

“Atëherë dije se nuk ka Zot tjetër pos All-llahut...” (Muhammed: 19)

Duke e marrë besimin (akiden) e tij nga dija dhe bindja, në menyrë që të jetë në grupin e besimtarëve të rrënjos besimi i të cilëve nuk luhatet. Dhe që të jetë në grupin e të mençurve të cilët në bazë të diturisë e kanë parë vërtetësinë e besimit (imanit) në Zotin xh.sh. dhe peygamberin e Tij, duke e ngritur vetën prej gradës së qorrave që nuk e dinë se zoti i tyre është i vërtetë (hak) dhe se peygamberj i Zotit të tyre është i vërtetë (hak), u ka ardhur atyre me të vërtetë.

“A është i nejtë ai që e di se ajo që t’u shpall ty nga Zoti yt është e vërtetë, si ai që është i verbër? Vetëm njerëzit e arsyeshëm që kanë mendje të shëndosh e kuptojnë të vërtetën.” (Rra’d: 19).

ATA JANË SIKURSE KAFSHËT, BILE EDHE MË TË HUMBUR

O ti i mençur, ruaju shumë nga pakujdesia, në menyrë që të mos bëhesh prej atyre të cilët nuk e falënderojnë Atë që i ka krijuar ata dhe u ka krijuar sy, veshë, zemra dhe organe të tjera të ndryshme. Mirëpo, duke qenë të pakujdesshem, nuk i kanë shfrytëzuar këto mjete të shtrenjta të cilat janë si mjete me të përshtatshme për njohjen e Krijuesit të tyre, përkundrazi ata u mbrapshten dhe refuzuan që t’i shohin argumentet e Zotit në krijesat e Tij, bile refuzuan edhe që t’i ndjejnë këto argumente në librin e Tij (Kur’anin).

Refuzuan që te mendojnë në atë që e kanë parë dhe në atë që e kanë dëgjuar prej argumenteve, duke i mbyllur dhe ngurosur veshët e tyre në mënyrë që të mos ndiejnë diçka që i përkujton ata me botën tjetër, i kanë ngurosur zemrat e tyre që të mos kuptojnë diçka prej asaj që e ka zbritur Zoti udhëzim dhe drejtim për ta. Andaj u detyruan që të varen nga krijesat duke i bërë të shenjta dhe duke i madhështuar ata, ndërsa ata nuk posedojnë për vete as dëm e as dobi.

U varën dhe adhuruan idhujt të cilët i kanë bërë me duart e veta prej gurëve dhe drunjve pasta planetet, zjarrin, lopët, njerëzit, xhinnët, yjet vetëtima shiun etj. prej krijesave të ndryshme. Gjithashtu politeistët (mushrkët) bashkëkohorë janë duke u varur dhe duke adhuruar një grumbuj idhujsh që u përmendën pak më lartë, duke i quajtur ato me emrin “Natyrë” duke u përlur përpara krijesave dhe madhëruar teoritë e ndryshme (teorj të cilat i kanë shpikur që janë të njohur si me të pamoralshëm egoistë, ziliqarë, gënjeshtarë e çka jo tjetër). E harruan Atë që i ka krijuar ata, i ngjalli dhe ua mori shpirtin atyre.

“Ata (idhujtarët) adhuironjë, në vend të All-llahut (idhuj) për të cilët nuk ka ardhur kurrfarë fakti dhe nuk kanë kurrfarë dije, pra për idhujtarët nuk ka ndonjë ndihmëtar.” (Haxhxh: 71).

“...Një shumicë (emohuesëve) duke mos pasur kurrfarë dije, por vetëm nga pasionet e tyre, duan t'i largojnë nga e vërteta (njerëzit). Po Zoti yt di më së miri për ata që i shkëlin dispozitat.“ (En’am: 119)

Shkaku kryesor i mosbesimit të njerëzve në një Zot është injoranca dhe pakujdesia e tyre ndaj vërtetësisë së besimit, nuk e kanë mësuar atë e as që i kanë shfrytëzuar dhe pasur dobi prej veshëve (dëgjimi) syve (të parët) dhe zemrës (të kuptuarit) në mësimin e argumenteve të besimit të cilat janë të qarta për çdo hulumtues dhe janë të njohura dhe grumbulluara përpara çdo dijetari.

Pasi që ata janë të pakujdesshëm ndaj të vërtetës, nuk mbetet tjetër përveç të pavërtetës (batilit) e cila nuk ka asnjë argument dhe dokument për të dhe e cila qëndron dhe ngritet në bazë të frazave dhe hipërbolave.

“... Thuaj ‘A mos keni ndonjë fakt e të na e prezentoni atë neve?’ Ju i mbështeteni vetëm hamendjes, në të vërtetë vetëm gënjeni.“ (En’am:148).

Pra, kuptohet se të pakujdesshmit (që janë në gaflet) nuk mundohen t’i përdorin mjetet e njohurisë për njohjen e Krijuesit të tyre, duke u konservuar në botën e hamendjeve dhe fantazive, pasi që e kanë vërë në harresë të vërtetën e cila u ka ardhur atyre nga Zoti i tyre dhe në bazë të kësaj janë bërë prej atyre të cilat e kanë merituar që rezultati i mbarimit të jetës së tyre në këtë botë (pabesimi) të jetë hyrja e tyre në zjarrin e xhehennemit përgjithmonë. All-llahu xh,sh. thotë:

“Ne krijuam shumë nga xhinnët e njerëzit për xhehennem. Ata kanë zemra që me to nuk kuptojnë, ata kanë sy që me ta nuk shohin dhe ata kanë veshë që me ta nuk dëgjojnë. Ata janë si kafshët, bile edhe më të humbur, të tillë janë ata të marrët.“ (A’raf: 179)

Nuk ka dyshim se krejt këta që janë në këtë botë të pakujdesshëm për besim në Zot, ditën e gjykimit do të pendohen (do të bëhen pishman), mirëpo në atë ditë nuk u kanë dobi as pendimi e as arsyetimi, All-llahu xh.sh. thotë:

“Dhe thonë: ‘Sikur të kishim dëgjuar dhe pasur mend, ne nuk do të ishim ndër banuesit e zjarrit’. Pra, i pranojnë mëkatet e veta, banuesit e zjarrit qofshin largmëshirës.” (Mulk: 10-11)

KA DËSHMUAR ALL-LLAHU QË AI ËSHTË DHE NUK KA ZOT TJETËR PËRVEÇ TIJ, PO ASHTU MELEKËT DHE DIJETARËT

Gjatë asaj që kaloi kuptuam se ai i cili ”ia ka mësuar njeriut atë që nuk e ka ditur” dhe i dha njeriut mjete për arritjen e dijes dhe njohuri, e ka bërë rrugën për besim në Të dhe në peygamberin e Tij që të jetë në bazë të studimit dhe përdorjes e shfrytëzimit të këtyre mjeteve. Andaj ka krijuar në ne mjete të cilat na shpiejnë deri te besimi në Të nëpërmjet rrugës së vërtetë, e ajo është rruga e dëturisë (studimit) All-llahu thotë:

“Atëherë dije se nuk ka Zot tjetër pos All-llahut...” (Muhammed: 19).

“A është i nejtë ai që e di se ajo që t’u shpal ty nga Zoti yt është e vërtetë, se ai që është i verbër? Vetëm njerëzit e arsyeshëm që kanë mendje të shëndoshë e kuptojnë të vërtetën.” (Rra’d: 19).

“(Sikurse plotësova mirësinë Time ndaj jush) Ashtu si dërguam nga gjiu i juaj të dërguar tu lexojë ajetet tona, të pastroj e të mësojë librin dhe traditën, e edhe t’u mësojë atë që nuk e dinit.” (Bekare: 151).

“Mos iu qas asaj për të cilën nuk ke njohuri, pse të dëgjuarit, të pamët dhe zemra, për të gjitha këto ka përgjegjësi.” (Isra: 36)

Po ashtu All-llahu xh.sh. na ka sqaruar se injoranca (mosdija) shpie kah mohimi dhe kufri (mosbesimi), sidomos nëse i bashkohet injorancës (mosdijes) edhe inati (kokëfortësia) atëherë

bëhet shkak kjo që të vuloset zemra e njeriut, në këtë rast nuk mund të kuptohet gjë prej të vërtetës të cilën nuk e di dhe e mohon.

“Në këtë mënyrë All-llahu vulos zemrat e atyre që nuk kuptojnë.“ (Rrum: 59)

Pra, me përdorimin e mjeteve të diturisë që na i ka dhënë Zoti xh.sh. të cilat i posedojmë dhe i drejtojmë ne, për njohjen e Zotit tonë dhe peygamberit të Tij, hymë në grupin e atyre të cilët kanë dëshmuar për njësinë e Zotit, duke i krahasuar ata Zoti i Madhërishëm në dëshminë e tyre me dëshminë e Vet pra, qoftë i lartësuar dhe nuk ka shok për Të.

“All-llahu vërtetoi se nuk ka zot tjetër përveç Tij, e dëshmuar edhe engjëjt e dijetarët, dhe se Ai është zbatues i drejtësisë...” (Ali-Imran: 18)

ASHTU I SQAROJMË ARGUMENTET PËR POPULLIN QË MENDON

Pasi që e ditëm se dituria është rruga më e mirë që shpie në besim, atëherë eja të shohim ca errësira të cilat na i sqarojnë shenjat e kësaj rruge. Do të shohim se njeriu nëse do ta dij të vërtetën ose ta mësojë një gjë që e ka pasur të panjohur, ai duhet ta ndjekë njëheren prej këtyre tri rrugeve:

SHPRESA DHE KUJTIMI

Ai (njeriu) e sheh një gjë, e përcjellë atë dhe mendohet (thellohet) në të, ose e provon, e dëshmon dhe kujton, pastaj e zbulon të vërtetën e cila ka qenë për të e panjohur para këtij momenti. E di se në qoftë se ngrohtësia e kaplon akullin e shkrin, ndoshta edhe e provon atë dhe arrin deri te zbulimi i së vërtetës të cilën e ka pasur të panjohur dhe të cilën nuk e ka parë përpara, e di pastaj se ngrohtësia e shkrin akullin dhe i qetësohet zemra ndaj kësaj të vërtete të cilën e diti në bazë të kuptimit të tij që e dëshmoj dhe e provoj.

Ndoshta e sheh erën e cila fryn nga një anë e caktuar, pastaj sheh se mjegullat erdhën nga e njëjta anë, mendja e njeriut kupton dhe nxjerr rezultate se era është ajo e cila i çon mjegullat, i tubon dhe i shpërndan. Në atë moment qetësohet njeriu dhe i dorëzohet të vërtetës të cilën e prodhoi mendja e tij në bazë të dëshmisë dhe eksperimenteve. Po ashtu e sheh prej së largu veturën duke ecur në rrugë, e sheh duke u kthyer në kthesë, e ndal shpejtësinë ku duhet të ndalet, shpejton ku duhet të shpejtojë, i sheh dritat e saja duke ndriçuar rrugën, në këtë moment kujtohet dhe vendos se vetura e ka dritën e vet që ia ndriçon rrugën asaj, se vetura është e mirë për punë (nuk është e prishur) dhe për udhëtim, dhe se ajo punon gjatë udhëtimit sikur që e sheh, dhe se ajo nuk është e prishur, se përndryshe nuk do të kishte mundur të ecë edhe pse ky nuk i sheh mjetet dhe motorin e saj, njëlloj edhe aparatit e dritës. Po ashtu duke menduar merr vendim se ai që e drejton veturën (shoferi) është i mençur, sepse ai që e drejton veturën me mend dhe kuptim, është i ushtruar, sepse e drejton veturën me vëmendje, precizitet dhe mjeshtri.

Nëse i shikojmë degët e pemeve duke u lëvizur dhe lloj-lloj trupash duke u rrëzuar në tokë, në qoftë se nuk ka kush i mban ato, atëherë mendët tona sjellin vendim se era është ajo e cila i lëviz

degët e pemëve dhe gravitacioni i tokës është ai i cili i tërheq dhe i rrëzon trupat e ndryshem në tokë edhe se ne nuk e shohim ajrin e as gravitacionin.

Ne këtë rrugë inzhinierët, mjekët, ekspertët, studentët në shkencat e tyre prezente dhe të gjithë njerëzit, përjetojnë shumë prej eksperimenteve, gjurmimeve e hulumtimeve të ndryshme të përditshme nëpërmes dëshmisë dhe mendimit ose eksperimenteve dhe mendimit, i cili çon deri te njohja e të vërtetës. Kjo rrugë është quajtur “rrugë shkencore”, ligji i cili e sundon këtë rrugë është quajtur “ligji i diturisë shkencore” dhe i cili mund të analizohet kështu: dëshmim haptasi ose eksperiment + mendim në atë që bie nën dëshmi = e vërteta shkencore.

Kështu pra, nëse i dëshmojmë gjurmët e të vërtetave dhe mendojmë në to, atëherë do të dimë vërtetësinë e Zotit të madhënishtëm dhe do të rehatohen zemrat tona ndaj kësaj njohurie. All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

“Në krijimin e qiejve e të tokës, në ndryshimin e natës dhe të ditës, ka argumente të qarta për ata që kanë arsye e intelekt. Për ata që All-llahun e për mendin me përkujtim kur janë në ulur, kur janë të shtrirë dhe thellohen në mendime rreth krijimit të qiejve e të tokës (duke thenë): Zoti ynë; këtë nuk e krijove kot, i lartësuar qofsh, ruana prej dënimit të zjarrit.” (Ali Imran: 190-191)

Pra, gjurmët e krijimit dëshmojnë se ato janë prej ndërtimit të Krijuesit.

- Gjurmët e maturesë dëshmojnë se ata janë prej ndërtimit të të Maturit.
- Gjurmët e përvojës dëshmojnë se ato janë prej ndërtimit të Specialistit.
- Gjurmët e njohurisë dëshmojnë se ato janë prej ndërtimit të Dijetarit.

- Gjurmët e furnizimit dëshmojnë se ata janë prej ndërtimit të Krijuesit Furnizues.
- Gjurmët e jetës dhe vdekjes dëshmojnë se ato janë prej ndërtimit të Ngjallësit dhe Vdekësit.
- Gjurmët e fotografimit të jashtëzakonshëm (të krijesave) dëshmojnë se ato janë prej ndërtimit të Fizionomistit Shpikës.
- Gjurmët e mëshirës (Rahmetit) dëshmojnë se ato janë prej ndërtimit të Dominuesit.
- Gjurmët e udhëzimit dëshmojnë se ato janë prej ndërtimit të Udhëzuesit.
- Gjurmët e fuqisë dëshmojnë se ato janë prej ndërtimit të të Fuqishmit.
- Gjurmët e mundësisë dëshmojnë se ato janë prej ndërtimit të të Mundshmit.
- Gjurmët e dëmit dhe dobisë dëshmojnë se ato janë prej ndërtimit të Atij që dëmton dhe bën dobi.
- Gjurmët e pasurisë dëshmojnë se ato janë prej ndërtimit të Pasanikut.
- Gjurmët e mbetjes dhe vazhdimit dëshmojnë se ato janë prej ndërtimit të Mbetësit dhe Vazhduesit.
- Gjurmët e njësisë dëshmojnë se ato janë prej ndërtimit të të Vetmit dhe të Njëtit.

Pra, nëse mendojmë dhe thellohemi në qenien (krijimin) që na rrethon neve nuk mund të shohim ose gjejmë ndonjë prej krijesave e cila cilësohet me këto cilësi që u lartpërmendën, por përkundrazi i gjejmë ata duke dëshmuar praktikisht se janë prej ndërtimit të Atij, i cili cilësohet

me këto cilësi, nga krejt kjo e dimë dhe e njohim se Ai është që nuk ka Zot tjetër përveç Tij (All-llahut).

Dhe me të njëjtën rrugë i studiojmë argumentet e të dërguarit Muhammedit sal-lall-llahu alejhi ve sel-lem dhe duke u menduar në të, do të gjejmë se çdo argument prej argumenteve paraqet dëshmi të prerë se Muhammedi s.a.v.s është peygamber i All-llahut. të Madherishëm. Po ashtu nëse i lexojmë librat e shenjtë të mëparshëm si p.sh.: Teveratin dhe Inxhillin do të gjejmë se ato sinjalizojnë dhe lajmërojnë se Muhammedi a.s. është peygamber i All-llahut xh.sh. dhe të cilët disa prej tyre deri sot gjenden (kam për qëllim shumëzimin e Inxhilave numri i të cilëve ka arritur më se 100).

Nëse shikojmë në oratorinë e Kur'anit të ndershëm, gjithmonë gjejmë se është e pamundëshme (që nuk mund kush) që xhinnet dhe njerezit në përgjithësi që të sjellin një sure të ngjashme me atë të Kur'anit, Kjo gjë (oratoria e Kur'anit) dëshmon dhe do të dëshmojë për çdo të mençur se Kur'ani është i zbritur nga Zoti i madhërishtëm dhe se Muhammedi s.a.v.s. është i dërguar i Tij.

Nëse studiojmë lajmet e abstrakcionit (të fshehtave) për të cilat na ka lajmëruar Muhammedi a.s. në kohën e tij dhe të cilat kanë ndodhur pas tij, ndodhin sot dhe do të ndodhin më vonë, gjejmë në to dëshmi të vërtetë për peygamberizmin e Muhammedit a.s.

Po ashtu nëse i shikojmë mrekullitë e jashtëzakonshme të cilat tregojnë për përmbajtjen e All-llahut xh.sh., gjithësinë dhe çka ka në të prej krijesave dhe argumenteve, pastaj në anën tjetër shikojmë zbulimet shkencore pas zbritjes së Kur'anit me sa shekuj dhe pas shpikjes së mjeteve dhe aparateve të ndryshme precize, studimeve të njëpasnjëshme, shohim se këto zbulime vijnë

për vërtetimin e asaj që lajmëron All-llahu në Kur'an nëpërmjet gjuhës së Muhammedit a.s. i cili ka qenë analfabet, gjë e cila dëshmon se Kur'ani ka zbritur me dijen e All-llahut xh.sh.

Po ashtu nëse shikojmë në mrekullitë e jashtëzakonshme me të cilat All-llahu fuqiptotë e ka përmbajtur pejgamberin e Tij, Muhammedin s.a.v.s. (po ashtu edhe të gjithë pejgamberët përpara tij) dhe të cilët janë regjistruar në Kur'an (sepse All-llahu ka lajmëruar për ta), i kanë dëgjuar ato besimtarët dhe i kanë besuar, sepse ata i kanë dëshmuar ato, i kanë dëgjuar pabesimtarët ato dhe i kanë besuar, mirëpo i kanë gënjyer, pastaj janë shndërruar prej kufrit (mosbesimit) në muslimanë, duke qenë të bindur ata se për ato që ka lajmëruar Kur'ani prej mrekullive dhe argumenteve nuk mund të jenë prej tjetër kujt vetëm se prej All-llahut fuqiptotë, p.sh.ndarja e hënës në dy pjesë, zbritja e melaikeve dhe luftimi i tyre krah për krah me muslimanët kundër pabesimtarëve, ndihma e erës muslimanëve, rënja e shiut, gjumi (në luftën e Bedrit) për të pushuar muslimanët etj., për të cilat ka lajmëruar Kur'ani. Nëse e studiojmë mënyrën e mbrojtjes së Kur'anit (nga ndryshimet) deri në ditën e gjykimit pa mos mundur kush të ndryshoje as një shkronjë prej tij, konstatojmë se me të vërtetë kjo gjë është prej All-llahut fuqiptotë dhe Muhammedi a.s. është me të vërtetë i dërguari i Tij dhe se krejt këto që ka lajmëruar All-llahu xh.sh. janë të vërteta, sepse këto gjëra janë të evidentuara në Kur'an në atë kohë në të cilën ka lajmëruar All-llahu për të dhe në të cilën janë parë dhe dëgjuar nga ana e muslimanëve dhe pabesimtarëve, duke i mos i mohuar ndokush prej presentëve dhe e ka mbrojtur Zoti xh.sh. Kur'anin të shëndoshë pa kurrfarë ndryshimi prej atëherë kur janë evidentuar këto mrekulli e deri në ditën e sotme. Nëse krejt këto i studiojmë mirë shohim se ato dëshmojnë se Muhammedi a.s. është pejgamber i All-llahut xh.sh. të cilin e ka përmbajtur Zoti i tij me çka nuk mund ta përmbajë atë askush tjetër përpos All-llahut xh.sh.

Në qoftë se ne e lexojmë historinë e as'habëve të peygamberit a.s. dhe simpatizimin e popujve të cilët i kanë çliruar ata, përmendjen e tyre, ndihmën në thirrjen e tyre i gjejmë krejtësisht në kundërshtim me atë që bëjnë sot popujt e mundur, të pushtuar nga pushtuesit e tyre, nëse këtë gjë e krahasojmë dhe e studiojmë mirë, shohim se simpatizuesit e Muhammedit a.s. të cilët e kanë provuar dhe e kanë bashkëjetuar, e kanë besuar dhe vërtetuar atë sinqerisht dhe bindshëm. Andaj jeta e tyre është dëshmitar me i mirë për besimin e tyre që kanë pasur dhe vërtetimin e tij, pasi që e kanë luftuar atë në fillim, e kanë nxjerrë prej shtëpisë së vet dhe lloj-lloj mundimesh që i kanë bërë. Mirëpo kur dëgjojmë për këto besimtarë të vërtetë, tregojnë për shkaqet e besimit të tyre në All-llahun xh.sh. dhe Muhammedin a.s. si peygamber i Tij, shohim se ata tregojnë për argumentet e sakta dhe të qarta të cilat nuk mund të jenë vetëm nëpër duar të peygamberit të vërtetë të cilin e përmban Zoti fuqiptotë. Dhe shohim se ato argumente janë transmetuar deri te ne nëpërmjet dijetarëve të as'habëve dhe tabinëve ndaj të cilëve kanë dëshmuar njerëzit me vërtetësinë, diturinë, përpikshmërinë dhe precizitetin e tyre dhe të dëshmojnë ato argumente se Muhammedi a.s. është peygamber i Zotit dhe robi i Tij.

Po që se e studiojmë sheriatin Islam se si ka korrur sukses dhe ka mbërritur që ta bëjë jetën e njerëzve më të lumtur të cilën e ka ditur njerëzimi në faqen e tokës dhe për të cilin dëshmojnë specialistët dhe profesorët e ligjeve dhe zakoneve prej muslimanëve dhe jomuslimanëve se: sheriatu Islam është i përshtatshëm dhe vazhdon për çdo kohë dhe vend. Ka sunduar shekuj me radhë dhe nuk kanë mundur t'i gjejnë atij ndonjë mungesë apo gabim (sepse ai është ligj i të Gjithëdijshmit) dhe sot e kësaj dite është e përshtatshëm dhe do të jetë deri në ditën e gjykimit, në mënyrë që t'ua realizojë shpresat njerëzve dhe t'ua bëjë jetën e tyre të fatshme, pas krejt këtyre mizorive që janë duke u bërë në këtë botë nga ana e terroristëve. Si shembull praktik janë fjalët e

ekspertëve dhe profesorëve të ligjeve dhe zakoneve njerëzore (të cilët i kanë shpikur njerëzit) të diet thonë se: është e pamundur për një ligj njerëzor të mbetet i përshtatshëm dhe të vazhdon për jetën e njerëzve me shumë se një shekull. Pra, nëse i studiojmë mirë këto fjalë gjejmë se të gjithë këto dëshmojnë se i vetmi ligj i cili është i përshtatshëm për çdo kohë dhe vend është sheriatu Islam të cilin e ka shpikur Krijuesi i gjithë botërave, vendeve dhe krijesave duke e ditur për çdo kohë dhe vend çka do të jetë e nevojshme, andaj këtij ligji nuk mund t'i vijë ligji tjetër përballë dhe nuk mund të vjen ligj me i përshtatshëm se sheriatu Islam në ndonjë kohë prej kohërave, sa do që të mundohen njerëzit. Është dëshmitar i çdokujt që studion atë (sheriatin) se ky është prej shpikjes së dijetarit të realitetit të shpirtërave (frymave) njerëzore dhe i di të gjitha bazat e natyrës së tyre të cilat nuk ndryshohen asnjëherë dhe të cilat sot e kësaj dite janë të panjohura të ligjdhënësit (të ata të cilët shpikin ligje për njerëzit duke mos u pajtuar me ligjin e Zotit i cili nuk u konvenon mizorëve). Kjo do të thotë gjithashtu se Muhammedi a.s. është peygamber i Zotit të vërtetë. Gjithashtu nëse e lexojmë dhe studiojmë historinë e Muhammedit a.s. nga librat e historisë Islame, gjejmë se ajo nuk mund të jetë histori e një njeriu të thjeshtë e as filozofi, por histori e njërit prej peygamberëve të Zotit fuqplotë, sepse gjithçka që ka të bëjë me të është pasqyrë e vërtetësisë dhe sinqeritetit të Muhammedit a.s.: me vetvetën, familjen e tij, as'habët e tij, pabesimtarët, kafshët dhe me të gjitha gjërat që ekzistojnë në botë, kjo do të thotë se Muhammedi a.s. ka qenë me të vërtetë peygamber i All-llahut xh.sh. të cilin e ka pastruar Zoti i tij nga çdo e keqe dhe e metë.

Pra, këto janë disa lloj studimesh të cilat kanë mundur të njohtohen me to dhe të cilat e çojnë njeriun deri te besimi i fortë i cili nuk luhetet asnjëherë, me kusht nëse njeriu i bën këto me vëmendje dhe kuptim. E gjen vetën dhe me çdo bindje duke e shprehur fjalën:

“Esh-hedu en La ilahe il-lall-llah ve Esh-hedu enne Muhammeden resulull-llah” që d.mth.: “Dëshmoj se nuk ka zot tjetër përveç All-llahut dhe dëshmoj se Muhammedi është pejgamber i Tij”. Ky besim i cili bëhet në bazë të të menduarit dhe studimit është besim i gjallë, i zgjuar dhe i ëmbël, besim fryt i të cilit është puna e mirë, dhe që nuk mund të depërtojë në zemrën e tij dyshimet sa do që të jetë fuqia e tyre, nuk është si besimi i cili trashëgohet prej prindërve apo vendit ku jeton, sepse ky besim nuk është i rrënjosur dhe çfarëdo ere e dobët të fryjë këtë lloj besimi e luhat bile edhe shumë lehtë e shkul prej vendit krejtësisht, dhe fryt i këtij besimi janë punët dhe sjelljet e këqija sikur që ndodh fatkeqësisht në vendet Islame, sepse besimi i shumicës së muslimanëve të vendit është trashëgues e jo nga studimi dhe dituria.

DËGJIMI DHE MENDIMI

Metoda e dëgjimit dhe mendimit po ashtu është një ndër rrugët kryesore për përfitimin e diturisë dhe njohurisë, sepse kjo rrugë është ajo nëpërmes të cilës transferohet dituria prej një njeriu në tjetrin p.sh.: mësuesi dhe ligjëruesi i transferojnë njohuritë e tyre te nxënësit dhe dëgjuesit e tyre nëpërmjet dëgjimit të tyre, kështu pra, të gjithë njerëzit me specializimet e tyre si p.sh.: mjeku, artisti, inzhinjeri, shoku dhe të gjithë pronarët e lloj-lloj profesioneve i transmetojnë njohuritë e tyre te dëgjuesit e tyre nëpërmjet dëgjimit në raste të shumta. Sikur te mos ishte dëgjimi, do të ishte shumë mendë për njerëzit në përgjithësi për t’u kuptuar mes vete dhe të gjithë njerëzit do të ishin të padijshëm, mirëpo nëpërmjet dëgjimit u shtohet njerëzve diapazoni dhe horizonti i diturisë së tyre. Nëse njerëzit pranojnë që diturinë ta marrin prej dijetarëve nëpërmes dëgjimit të

fjalëve të tyre do të thotë se ata kanë mësuar atë që nuk e kanë ditur dhe se njerëzit kanë besim ndaj tyre, gjë e cila i shtynë ata që ta vërtetojnë fjalën e tyre.

Shumicën e ndodhive të cilave u besojnë njerëzit në shkenca të ndryshme i kanë marrë ato në bazë të besimit të tyre ndaj atyre njerëzve të cilët kanë lajmëruar për to, në të njëjtën mënyrë të besuar të të gjithë të mençurit, vjen edhe besimi në Zotin e vërtetë, duke iu shtuar atij qartësia, hapësira dhe rrënjësia në fe. All-llahu i madhëruar ka zgjedhur pejgamberin a.s. sikur që edhe ka zgjedhur para tij pejgamberë, duke ia treguar Zoti xh.sh. atij (Muhammedit a.s.) shumë gjëra (argumente) dhe në Kur'an thotë kështu:

“Zemra nuk e mohon atë që e pa (me sy). A po beni polemicë atij për atë që e ka parë? Atë (Xhibrilin e ka parë edhe herën tjetër (E ka parë,) tek Sidretul Munteha. Që pranë sajë është xhennetul Me’va (kopsht strehimi i...). Atëherë kur Sidrën e mbuloi çka e mbuloi. Shikimi (I Muhammedit) as nuk lakoi e ai nuk tejkaloi. Ai (Muhammedi) vërtetë, pa disa nga shenjat më të mëdha të Zotit të vet.” (Nexhm:11-18)

All-llahu xh.sh. na e ka dërguar pejgamberin Muhammedin a.s. që të na mësojë atë që nuk e kemi ditur në lidhje me Krijuesin tonë, fenë tonë, të kaluarën tonë, të ardhshmen tonë, qëllimin e krijimit tonë, gjëra të cilat është e pamundshme që t'i dimë në vetë pa na treguar askush për to. All-llahu xh.sh. në Kur'an thotë:

“(sikurse plotësova mirësinë Time ndaj jush) Ashtu siç dërguam nga gjiu i juaj të dërguar t'u iexojmë ajetet tona, të pastrojë e të mësojë librin dhe traditën, e edhe të mësojë atë që nuk e dinit.“ (Bekare: 151) Andaj besimtarët e vërtetë nuk besojnë jashta pejgamberit të vërtetë i cili ka ardhur nga ana e Zotit me të vërtetë dhe me argumente të sakta e që vërtetojnë pejgamberinë e tij

dhe vërtetësinë ndaj së cilës qetësohet zemra e tyre, Kur'anin (librin) me të cilin është dërguar, kjo është gjë të cilën duhet besuar sepse me anë të pejgamberit dhe librit të All-llahut transmetohet dituria nga Zoti i gjithësisë “dituria e të cilit ka përfshirë çdo gjë” dhe “Dijetar i të fshehtave (abstrakteve) që nuk lëshon nga pamja e Tij, asnjë pjesë atomi qoftë në qiell apo në Tokë, çdo gjë është në librin e qartë (në Lehti Mahfudh)”. Dhe se me anë të saj i besojnë pejgamberët të cilët na e kanë vërtetuar drejtësinë e tyre dhe drejtësinë e librave të tyre me të cilët i ka dërguar Zoti i Madhërisëm te njerëzit. All-llahu xh.sh. thotë:

“Ne i dërguam të dërguarit tanë me dokumente të qarta...” (Hadid: 25)

Kjo rrugë e lartpërmendur është rruga e dytë për besimin në Zot dhe e cila nxit kah rruga e parë, duke e sqaruar e plotësuar atë që ka mbetur e paqartë njohurinë e njerëzve për Zotin e tyre. E njëjta rrugë është edhe ajo të cilës janë përmbajtur të mençurit për kërkimin e diturisë të çdo dijetarit, i cili është i sigurt dhe i vërtetë në diturinë e vet. Andaj besimi ynë në vërtetësinë e librit të shpallur Muhammedit a.s. (Kur'ani) vjen gjithashtu nga kjo rrugë, rrugë e dëgjimit nga anët e vërteta, të besuara dhe të shumta, të cilat është e pamundshme që të pajtohen të gënjejnë dhe të bashkohen në të. Pra, nëse ne e degjojmë muslimanin nga Kina, India, Pakistani, Irani, Iraku, Turqia, Siria, Libani, Jordania, Palestina, Gadishulli Arabik, Egjipti, Sudani, Libia, Tunizia, Algeri, Maroku, Mauritania, Nigeria, Senegali, Mali, Çadi, Somalia, Etiopia, Tanzania, Amerika, Evropa, Australia dhe nga të gjitha vendet tjera, duke na treguar çdonjeri prej tyre për historinë e vendit të vet, për historinë e ardhjes së Islamit në këto vende, për udhëheqësit e ushtrive muslimane të cilët i kanë çliruar këto vende, atëherë do të shohim se historia e këtyre vendeve e vërteton njëra-tjetrën dhe dëshmon njëra për tjetrën, gjë që është e pamundshme që të gjithë popujt e këtyre vendeve me ndryshimin e kombeve, gjuhëve dhe mendimeve, të bashkohen dhe pajtohen për

ndonjë rrenë apo falsifikim që ta transmetojnë të gjithë këto njerëz me metodë dhe formë të njëjtë.

Nëse i pyesim muslimanët e këtyre vendeve se si ka qenë besimi i çliruesve dhe thirrësve në Islam, të cilët kanë ardhur te ju si thirrës në fenë e All-llahut, përgjigja e atyre të cilët e transmetojnë historinë e tyre do të ishte se: njerëzimi nuk ka ditur e as që ka parë ndonjëherë me parë çlirues dhe thirrës në fenë e All-llahut sikur këta që u janë përmbajtur rregullave të Zotit, duke shpresuar atë që është te Zoti (xhenneti) dhe duke iu frikuar të ardhshmes-Ahiritit xhehennemit. Gjë e cila i ka bërë këta popuj të çliruar të jenë të bindur ndaj vërtetësisë së besimit të tyre, sinqeritetit, vendosjeve (mjeteve) të tyre për Zotin e tyre dhe vërtetësisë së besimit të tyre në Muhammedin a.s., andaj edhe hynë me to në fenë e All-llahut, duke e falur namazin, duke dhënë zekatin, duke agjëruar Ramazanin, duke kryer haxhxin, u edukuan me moralin Islam dhe sunduan me shariatën Islam, të gjitha këto i lanë pasi që dëshmuar bashkë me ta që nuk ka zot tjetër përveç All-llahut xh.sh. dhe Muhammedi a.s. është rob dhe pejgamber i Tij.

Ky përqaftim i fesë Islame nga ana e këtyre popujve ka qenë pas armiqësisë që e kanë pasur dhe luftërave që i kanë zhvilluar kundër fesë Islame dhe muslimanëve në përgjithësi. Me vonë shohim se kjo armiqësi e egër është shndërruar në vëllazëri, urrejtja (hidhërimi) në dashuri, lufta në paqe dhe fitorja nga ana e të gjithëve për fenë e All-llahut xh.sh. kundër armiqve të Tij, edhe nëse këta armiq ishin prindërit, bijtë dhe vëllezërit e tyre. Pra, këtë lloj ngjarje e gjejmë të njëjtë te të gjithë këta popuj të cilën e transmetojnë muslimanët për vërtetësinë e as'haveve të Muhammedit a.s., çliruesit të këtyre vendeve.

Pra, nëse i mençuri mendohet pak në atë që dëgjon për këta popuj, e di se vërtetësia e këtyre popujve muslimane ndaj fesë së tyre dhe interesimi i fortë i tyre për përmbajtjen e rregullave të saj, dëshmon për besimin dhe bindjen e çliruesve në Zotin e plotfuqishëm dhe peygamberin e Tij, interesimin e tyre për përcjelljen e tij (Muhammedit a.s.) shpenzimin e pasurive të tyre dhe për sakrificimin e tyre në rrugë të përhapjes së fesë së All-llahut xh.sh., duke mos kërkuar prej njerëzve apo dikujt tjetër përvec Zotit të vërtetë as shpërblim e as falenderim. Andaj nëse i pyesim muslimanët e Lindjes dhe Perëndimit, apo Jugut ose Veriut për ndonjë çështje fetare, përgjigja do të ishte e njejtë dhe pa ndryshim, duke dëshmuar të fundit njësoj si të parët. Gjë e cila na qet përpara sqarimeve të ndryshme dhe dokumenteve të plota, të cilat na e sqarojnë neve bazën për të cilën kanë dëshmuar breza me radhë një pas një në Lindje dhe Perëndim për vërtetësinë e librit të All-llahut (Kur'anit) që i është shpallur Muhammedit s.a.v.s., i cili me të vërtetë është peygamber i All-llahut. Zoti xh.sh. thotë:

“Ne të kemi shpallur ty (Muhammed) argumente të qarta dhe ato nuk i mohon askush, përvec atyre që kanë dale respektit.” (Bekare: 99)

Këto dokumente muslimanët i tubuan në libra të veçanta të cilat mësohen në mbarë botën Islame me tituj të ndryshëm si p.sh. “Dokumentet e peygamberizmit ose “Muxhizet e Muhammedit”, dhe të ngjashme. Këto dokumente, argumente neve na kanë ardhur nëpërmes atyre të cilëve u është dëshmuar për vërtetësinë e besimit të tyre në Lindje dhe Perëndim, duke i shoqëruar ata në atë besim. Ata janë të cilët i kanë prezentuar dhe dëshmuar ata argumente dhe muxhize (mrekulli).

Transmetuesit e këtyre argumenteve janë ata të cilëve u është dëshmuar me dituri, devotshmëri, përpikshmëri dhe përmirësim nga bijtë e Lindjes dhe Perëndimit në kohërat e ndryshme. Kështu pra, përforcohet besimi dhe rrënjohet pasi që t'i dëgjojë këto argumente dhe muxhize të cilat i kanë transmetuar muslimanët brez pas brezi nga shtypet me të sakta dhe të vërteta. Ne këtë mënyrë të mençurit i shtohet besimi dhe bindja se Muhammedi a.s. është me të vërtetë pejgamber i All-llahut xh.sh.

KOMUNIKIM I DËSHMUAR

Kjo është rruga e tretë me të cilën nuk kënaqet asnjë me ecjen në të dhe dëshmim të argumenteve dhe dokumenteve të saja, me përjashtim të atij i cili e vërteton supozimin e tij dhe ec në rrugë të besimit, duke u thelluar në studime, gjurmime dhe përmirësime (të librave të vjetër). Besimi i përfituar në bazë të provave të dëshmuara praktike është i paluhatshëm, ky lloj besimi është gradë me e lartë e besimit.

Besimin në Zot nëpërmes kësaj rruge All-llahu xh.sh. ia ka bërë dhuratë atij i cili beson Atë, e respekton dhe i përgjigjet Atij duke e hapur derën e bashkëpunimit me të (njeriu) direkt dhe ia ka bërë të mundshme atij-njeriut që t'i shohë argumentet e All-llahut xh.sh. (krijimin e Tij), pa kurrfarë perde, shkaqet dhe krijesat në përgjithësi dhe atë me përgjegjjen e lutjeve të besimtarëve. Këtë gjë e kanë dëshmuar vet kush e di sa herë dhe e kanë ditur bashkë me mua me mijëra dhe miliona besimtarë, sikur që praktikohet nëpër vendet muslimane si p.sh.: namazi për shi, atëherë

kur kaplon thatësia. Në këtë moment i sheh besimtarët duke iu lutur të plotfuqishmit All-llah, falen dhe luten pandërprerë, derisa Zoti i Madhërishëm t'u përgjigjet lutjeve të tyre, gjë të cilën mund ta dëshmojë secili që don të vërtetohet, ose dikush që është i goditur me sëmundje ndaj të cilës kanë stagnuar të gjithë mjekët për shërimin e saj, kurse në anën tjetër duke iu lutur Zotit dhe duke duruar ndaj asaj sëmundje e sheh se shërohet, këso shembuj ke plot p.sh.: sa njerëz ka që i di vetë të cilëve u kanë thenë mjekët specialistë se nuk ka shpëtim, mirëpo në anën tjetër e sheh se pas pak kohe shërohet duke iu lutur Zotit ai vet ose tjetër kush për të. Mirëpo kjo metodë mund të realizohet te njeriu vetem me dy kushte: 1. nëse iu përgjigje urdhërave të All-llahut xh.sh. dhe e përcjell fenë e Tij, dhe 2. nëse beson në Zotin fuqiptotë me besim të vërtetë. All-llahu i Madhërishëm thotë:

“E kur robët e Mi të pyesin ty për Mua, Unëjam afër, i përgjigjem lutjes kur lutësi më lutet, pra për të qenë ata drejt të udhëzuar, le të më përgjigjen ata Mua dhe le të më besojnë Mua.“ (Bekare: 186)

Këtë gjë mund ta dëshmojmë haptazi, se si All-llahu i Madhërishëm i përgjigjet lutjes së atij që bie ngusht në jeten e vet, atëherë kur kthehet te Zoti dhe i lutet Atij me vërtetësi dhe sinqeritet. Pra, ai cili e arrin këtë gradë dhe e përcjell këtë rrugë, e gjen vetën në mesin e dashamirëve të Zotit, besimtarë të cilët kënaqen-posedojnë përgjigjen e Zotit të gjithësisë për lutjet e tyre. Andaj o i mençur mundohu që të jesh prej këtij grupi dhe mundohu që ta arrish këtë gradë duke i plotësuar kushtet e tij. Pra, nëse muslimanët arrinë këtë gradë, atëherë All-llahu i Madhërishëm do t'u aplotësojë çdo dëshirë të tyre. Kur i mençuri të kujdeset pak në përgjigjen e Zotit robërve të vet e kupton se ai i cili i shëron të sëmurët pa asnjë shkak shërimi pas lutjes është All-llahu i Madhërishëm i Cili u është përgjigjur besimtarëve çdo herë tash, por edhe ditën e gjykimit, i Cili e

dëgjon thirrësin besimtar në Lindje edhe atë në Perëndim, atë me zë të ulët dhe atë me zë të lartë dhe në çfarëdo gjuhe të jetë thirrja.

Pra, kur të mendojë pak e di se është duke komunikuar praktikisht me dëgjuesin përgjigjes (All-llahun) dhe shtohet besimi ynë se Muhammedi a.s. është peygamber dhe rob i All-llahut. Nëse e përcjellim këtë rrugë, rrugën praktike e cila ka ngjare me të vërtetë në historinë e muslimanëve dhe është duke ngjarë në jetën e përditshme të besimtarëve të vërtetë. Kurse çka ka ndodhur në kohërat e mëparshme dhe është shkruar në historinë e popujve të ndryshëm, disa prej tyre i tregojnë edhe Kur'anin i ndershëm, është ndihma e Zotit fuqplotë dhe përmbajtje hyjnore të cilën ua ka dhënë ummetit të Muhammedit a.s., dhe si ndihmoi Zoti kundër armikut të tyre, dhe ua bën jetën më të lumtur të cilën e njohu historia njerëzore. Ndoshta dikush mendon se lumturia fitohet me pasuri o me të ardhurat materiale, duhet ditur se këto janë shkaqe sekundare që e bëjnë jetën e njeriut të lumtur. Kurse shkaqet kryesore (primare) janë: besimi(imani), pëlqimi me caktimin (kaderin) e All-llahut xh.sh., qetësia për të ardhmën dhe jeta në gjirin e moralit të ngritur Islam me të tjerët.

Kënaqësitë e kësaj bote janë vetëm një nder shumë shkaqet sekundare për lumturi, sepse shohim shumë shtete të cilat i kanë realizuar shumicën e këtyre kënaqësive, por jetojnë të palumtur dhe në fatkeqësi, shumicën e njerëzve të atyre shteteve bëjnë vetëvrasje në menyre që të shporen nga goditjet dhe fatkeqësitë e kësaj jete.

Andaj, vëllezër të dashur, edhe ishte populli musliman - populli më i mirë të cilin e diti njerëzimi. U ndihmoi All-llahu xh.sh. dashamirëve të Vet në tokë dhe ua plotësoi atyre premtimin të cilin e përmend në Kur'an duke thënë:

“A tyre nga mesi i juaj të cilët besuan dhe bënë vepra të mira All-llahu u premtoi se do t’i bëjë zotërues në atë tokë ashtu si i pat bërë zotërtues ata që ishin para tyre dhe fenë të cilën Ai e pëlqeu për ta do ta forcojë, e në vend të frikës Ai do t’u dhurojë siguri. Ata më adhurojnë Mua e nuk më shoqërojnë asgjë. E kush edhe pas kësaj mohon, të tillët janë ata më të prishurit.“ (Nur: 55)

Duhet ditur se këtë lumturi e kanë vetëm besimtarët e vërtetë dhe të sinqertë prej ummetit të Muhammedit a.s., të cilët në çfarëdo gjendje nuk janë luhatur, si kur kanë qenë në krizë, po ashtu edhe në liri, si në frikë ashtu edhe në siguri, kur kanë qenë të fuqishëm edhe kur kanë qenë të dobët dhe duke mos i marrë parasysh dëshmitë e njerëzve, të cilët dëshmojnë për moralin dhe karakterin e mirë të tyre.

Këtë Kur’an që e kemi para duarve tona është dokument i qartë dhe dëshmon se çdokush që thellohet në të e di se ky Kur’an është prej Zotit xh.sh.

dhe Muhammedi a.s. është peygamber dhe rob i Tij, dhe kush e studion këtë libër (Kur’anin) të ndershëm dhe thellohet në shkencat e tij shoh se krejt ajetet (versetet-vargjet) e Kur’anit dokumentojnë se ky libër është vetëm prej All-llahut fuqiptotë dhe se Muhammedi a.s. është peygamber i Tij. All-llahu xh.sh. thotë:

“A nuk e studiojnë me vëmendje Kur’anin? Por jo, ata janë zemra që kanë drynat e vet.“ (Muhammed: 24)

All-llahu fuqiptotë në Kur’anin e ndershëm i thirrë pabesimtarët në përvojë praktike duke u thënë:

“E në qoftë se jeni në dyshim në atë që Ne ia shpallëm gradualisht robit tonë atëherë sillnie ju një kaptinë të re ngjashme si ai (Kur’ani) dhe thirrni (për ndihmë) dëshmitarët tuaj (zotërat) pos Allahut, nëse jeni të sinqertë (në thëniet tuaja se Kur’ani nuk është prej Zotit). E mos e paçit bërë (deri më tash), e as që do ta bëni kurrë (edhe në të ardhmën,), atëherë ruajuni zjarrit, lendë e të cilit janë njerëzit dhe gurët, që është i përgatitur për mosbesimtarët.“ (Bekare: 23-24)

Kur’ani i bekuar i ka vecorite e veta, prej veçorive të tij është perterirja e tij e perhershme, sepse sado që ta lexojnë atë njerëzit nuk mërziten kurrë. Pra, ndokush prej njerëzve a mundet të bëjë një gjë të tillë? Gjithashtu Kur’ani ka edhe veçori të tjera të shumta të cilat po ashtu i bëjnë njerëzit të pamundur që të bëjnë diçka të tillë, dokument të gjallë kemi Kurejshët të cilët u munduan me mish e me shpirt që ta bëjnë të rrejshëm Kur’anin dhe Muhammedin a.s., mirëpo në fund nuk paten çare pa iu nënshtuar fesë

Islame dhe Kur’anit pasi që e gjuajtën atë me magji. Këto përvoja sot e kësaj dite qëndrojnë para nesh, dokumentojnë dhe japin shenjë që Kur’ani i Madhërishtëm është i zbritur prej anës së Allahut fuqiplotë. All-llahu xh.sh. thotë:

“Thuaj: ‘Kjo është rruga ime, e vënë në fakte të qarta, e që unë thërras te All-llahu, unë dhe ai që vjen pas meje...’” (Jusuf:108)

Pas krejt kësaj duhet ditur se rruga e besimit është studimi dhe kuptimi. Ai që ndjek këtë rrugë d.m.th. e ka ndjekur rrugën e vërtetë dhe beson me bindje dhe e ka shfrytëzuar dëgjimin, të parët dhe mendjen e vet, e di rrugën që e çon deri te besimi në Zot, i Cili e ka filluar krijimin dhe Atij do t’i kthehet çdo gjë, pastaj ai do të marrë në llogari të gjitha krijesat.

HAPA KONKRETË

Kush dëshiron të përfitoj besim me anë të argumenteve dhe shkencës, fryt i të cilit është puna e mirë dhe të cilin nuk e sulmojnë dyshimet, ose të njëjtën gjë e dëshiron për familjen, vëllezërit, shokët dhe të afërmit e vet, duhet ndjekur librat të cilat bëjnë fjalë për bazat e besimit Islam, ose kërkon ndonjë dijetar Islam i cili ia shpjegon vërtetësinë e Islamit (besimit) dhe i sqaron dokumentet Kur'anore. Pastaj atij i duhet që t'i shoqëroj dijetarët (ulematë) nëse don të marr dituri Islame dhe t'i shoqëroj besimtarët e vërtetë nëse do të pasurohet me besim të vërtetë Afër mendjes është kjo që u lartpërmend, sepse nuk merret asnjë gjë prej atij që nuk është i specializuar për atë gjë, gjë normale është që çdo shkencë ose profesion merret vetëm prej atij që është i specializuar në atë shkencë ose profesion si p.sh.: medicina kërkohet prej mjekut, inzhinieria prej inzhinierit, feja Islame kërkohet prej dijetarëve Islamë etj. e jo sikur që ndodh me shumicën e njerëzve të cilët për fat të keq dëgjojnë fjalë të ateistëve për fenë Islame, ose të njerëzve të cilët nuk janë as të specializuar as kompetentë për të shpjeguar fenë Islame e pastaj ndodhin shpjegime të gabuara ose të pamjaftueshme. Pra, ata të cilët dëshirojnë që ta dinë fenë Islame me anë të studimit (mësimin) u nevojitet arma më e fortë për të cilën ua porosit All-llahu xh.sh. dashamirëve të Vetë që të armatosen me to, e ajo armë është durimi (sabir). Zoti thotë:

“Por për mua, Ai All-llahu është Zoti im, e Zotit tim unë nuk i bëj shok askënd! E pse ti kur hyre në kopshtin tënd nuk the: Ma shaeall-llah, la kuvvete il-la bil lah çka do, bëhet, s 'ka fuqi pa ndihmën e Tij). Nëse ti më sheh mua se unë kam më pak prej teje edhe pasuri edhe fëmi (krah më të dobët). Po unë shpresoj se Zoti im do të më japë edhe më të mirë nga kopshti yt, e këtij tëndit t'i shkaktojë fatkeqësi nga qielli e të gdhijë tokë e lëmuar (e zhveshur).“ (Kehf: 38-40)

Kurse nese je prej atyre që e kanë besimin e mbathur (të trashëguar) nga prindërit dhe gjyshërit e tyre, atëherë nxito dhe ndjeki të njejtat hapa të lartpërmendura, ti dhe familja yte që të pasuroheni me vërtetësitë e besimit, të bëheni prej atyre të cilët kanë besuar në bazë të diturisë dhe të bëheni prej të mençurve. Mirëpo nëse mbetesh me atë që ke trashëguar nga prindërit, atëherë dije se e ke zgjedhur rrugën të cilën e lufton (ashpër) Kur'ani ku All-llahu xh.sh. thotë:

“E kur u thuhet atyre (idhujtarëve): ‘Pranoni atë që All-llahu e shpalli!’ Ata thonë: ‘Jo, ne ndjekim atë rrugë në të cilën i gjetëm prindërit tanë!’ Edhe sikur prindërit e tyre të mos kenë kuptuar asgjë dhe të mos jenë udhëzuar në rrugën e drejtë (ata do t’i pasonin)?” (Bekare: 170)

Nga kjo kuptohet se nëse vendoset besimi në zemrën e njeriut, ai aktivizohet për të punuar punë të mira. Kur të nisë njeriu të punojë punë të mira dhe i bën qëllimet e sinqerta për Zotin xh.sh. sheh se besimi i tij i shtohet dhe kur ta shohësh se të pengon diçka për arritjen e qëllimeve të mira, atëherë kërko ndihmë prej Zotit Fuqplotë, pastaj prej besimtarëve të vërtetë, kështu do t’i mundish kreyt ato probleme me lejen e Zotit xh.sh. Në anën tjetër ke kujdes që të mos bëhesh ndihmës i mizorëve dhe mbaju urdhërit të Zotit tënd ku thotë:

“... Ndhimohuni mes vete me të mira dhe në të mbara, e mosni në mëkate e në armiqtësi. kini dro dënimit të All-llahut, se me të vërtetë All-llahu është ndëshkues i fortë.” (Maide: 2)

INATI I PABESIMTAREVE

Në të vërtetë pabesimtar është ai i cili i përton udhëzimit dhe ja zbukuron shejtani atij se në interes të tij është përballimi dhe luftimi i besimit dhe frikësohet se mos po i humb interesat e kësaj bote po të dalë besimi fitues. Frikohet që të mos dal fitues besimi, e pastaj t'i kthejë epshet e tija aventuriere në jetë të ndershme. Këtij lloj pabesimtari nuk i mjaftojnë dokumentet dhe argumentet e lartpërmendura dhe se ai mjafton me një apo me gjysmë argumenti të bindet për ndonjë çështje botërore, kurse sa u përket çështjeve fetare bëhet kokëfortë dhe mendjemadh, mundohet si e si të shpikë dyshime rreth fesë dhe të shpikë metoda të ndryshme për pengimin e njerëzve nga rruga e Zotit. Kështu pra ky lloj njeriu kur e thirr të besojë në Zot, parashtron kushte të jashtëzakonshme, ndër të gjitha propagandat e pabesimtarëve që janë të përhapura, fjala e tyre e njejtë sikur fjala e të parëve, duke thënë:

'Na e trego Zotin haptas'. çka duan këta inatçi?

Këta duan që ta shohin All-llahun tash edhe atë haptazi, para tyre me sytë e ballit. Mirëpo a thua munden këta sy shkurtpamës, të pamundur dhe të kufizuar ta shohin Zotin haptazi? Eja të shohim mundësitë dhe fuqitë e syrit me të cilin kërkojnë pabesimtarët që ta mbërrijnë pamjen e Zotit. A mundet ta shohë syri ajrin, të cilin e ndjen dhe i cili shtrihet para tij me qindra kilometra? Përgjigja është jo...jo. A i sheh syri valet e radios, të televizionit, të teleksit etj.? A mundet të shohë syri shpirtin të cilin e mban në trup të vet dhe i cili e dallon të gjallin prej të vdekurit? A mund të shohë mendtë e veta, që e dallojnë të mençurin prej të çmendurit? Përgjigja është jo...jo. A mund syri të shohë fuqinë magnetike, e cila tërheq ose largon pjesën e hekurit? Përgjigja është kurrsesi. A mund ta durojë syri fuqinë e dritës elektrike e drejtuar kah ai? Përgjigja është se ai nuk mund ta

qëndron dritën e fortë. Atëherë pasi që syri nuk ka aftësi ti shohë shumicën e gjerave që i ka afër vetës dhe pasi syri ka të kufizuar të parët e tij, që nuk mundeshka t'i mbërrijë gjërat e larta dhe të afërta e as që mundeshka ta durojë dritën e diellit i cili është me larg se sa që mendohet, atëherë të shohim se a mundet ky sy që e posedojmë e ta shohë se kush qëndron pas ndonjë objekti? a mundet t'i shohë të gjitha kontinentet e botës? ose t'i shohë të gjitha planetet dhe yjet e qiellit? ose a mundet t'i duron rrezet e diellit? Përgjigjja është e qartë se nuk mundet, kursesi. Pra pasi që syri paska qenë i kufizuar dhe i pamundur, nuk ka aftësi t'i shohë gjërat që janë larg tij, ose të shumtat që janë afër tij, ose që janë me dritë të fortë sikurse dielli, llambat elektrike etj. atëherë si mund t'i bjen dikujt ndërmend që me këta sy të kufizuar dhe të paaftë të kërkojë të shohë Zotin e gjithësisë? Të shohim si:

Largësia mes nesh dhe diellit është afro 93 milionë mila, ndërsa rrezet e diellit këtë largësi e kalojnë për 8 minuta d.m.th. në sekondë rrezet kalojnë afro 300000 km., kurse në anën tjetër ylli që është me afër tokës, drita e tij na mbërrinë pasi që udhëton afro 4 vjet e 5 muaj. Ndërsa udhëtimi i dritës së disa yjeve derisa të mbërrijë në tokë zgjat afër një qind (100) vjet, e disa te tjerë një mijë (1000) vjet e kështu me radhë me miliona, me miliarda dhe me biliona vjetësh, këtu shtrojmë pyetje: ku qëndrojnë këto yje atëherë? të lexojme së bashku fjalët e Zotit:

“Betohem në shuarjen (perëndimin,) e yjeve. E ai është betim i madh, sikur ta dini!” (Vakia: 75-76)

Pra, me përcjelljen e shpikjeve të astronomëve shohim se me të vërtetë vendet e yjeve janë të mëdha dhe shumë të largëta në kozmos (galaksi). Krejt këto yje që i shohim të afërta dhe të largëta janë zbukurim i qiellit të parë:

“Ne, qiellin më të afërt e kemi zbukuruar me kandila (yje ndriçuese,) dhe ata i kemi bërë gjuajtës kundër djajëve...” (Mulk: 5)

Pas këtij zbukurimi të yjeve vjen qielli i parë. Pastaj zbrazëtira në mes qiellit të parë dhe qiellit të dytë, gjithashtu me radhë i treti, i katërti, i pesti, i gjashti, i shtati qiell me zbrazëtitat e veta në mes qiejve. Pastaj me radhë vjen Kursia e Rrahmanit (Zotit) që i ka përfshirë të gjithë qiejt të cilat janë në krahasim me Kursinë e Zotit xh.sh. si shtatë dinarë (të hekurit) të gjuajtura në ndonjë tavolinë të madhe, siç tregohet në hadith. Pas Kursit vjen Arshi i Rrahmanit (Zotit), i cili ua tejkalon me madhesi të gjitha krijesave, sa që nëse bashkohen krejt qiejt, planetet dhe Kursi i Zotit janë si një gur i vogël në shkretëtirë. Andaj ki kujdes për madhërinë e All-llahut xh.sh. në krahasim me krijesat e Tij. Pra çka kërkojnë pabesimtarët? Ata për besim kushtëzojnë që ta shohin All-llahun haptas, me syrin i cili nuk mund t’i shohë gjërat e thjeshta siç u lartpërmendën, në anën tjetër pabesimtarët kërkojnë që ta shohin dritën e All-llahut me të njëjtat sy të cilët stagnojnë para rrezeve të diellit, derisa “*All-llahu është dritë (ndriçues) e qiejve e i tokës.*” (Nur: 35),

Fakt të gjallë e kemi ngjarjen e Musaut a.s. me All-llahun xh.sh. atëherë kur Musa a.s. kërkoj prej All-llahut xh.sh. që ta shohë Atë haptazi, pasi që atë e detyroi populli i vet (beni israilët) i thanë: “...ne nuk të besojmë ty derisa ta shohim All-llahun haptazi...” (Bekare: 55)

Kur Musa a.s. iu lut All-llahut t’i dalë atij haptas pasi që e përfundoi bisedën me Të, Ai i tha se ti nuk mund të më shohësh Mua kurrsesi, por shikoje kodrën (që e kishte para veti) nëse qëndron ajo në vend të vet atëherë do të mund të më shohësh Mua. D.m.th. All-llahu e qiti atë në provim praktik në mënyrë që të jetë shembull për të njejtët njerëz që do ta kërkojnë të njejtën gjë, All-llahu xh.sh. thotë:

“E kur Musai erdhi në kohën që e caktuam dhe i foli Zoti i vet, ai tha: ‘Zoti im! Më mundëso pamjen tënde e të shikoj!’ Ai (Zoti) i tha: ‘Ti nuk ke mundësi të më shohësh, po, shiko kodrën, e nëse ajo qëndron në vendin e vet, ti do të më shohësh Mua. Kur u drejtua kah kodra, një pjesë e dritës nga Zoti i tij e bëri (Kodrën) atë thërrmi e Musait i ra të fikët. Kur erdhi në vete, tha: ‘E lartë është madhëria Jote, pendohem te Ti (për atë që kërkova), dhe unë jam i pari i besimtarëve!’” (A’raf: 143)

Kështu pra shohim se kodra e cila është kushedi sa më e fuqishme se njeriu, megjithatë nuk ka mundur ta qëndrojë pamjen e Zotit, e si mundën pabesimtarët ta kërkojnë një gjë të tillë me sytë të cilët nuk mundin ta durojnë dritën e rrezeve të diellit ose çfarëdo drite tjetër.

Nuk ka dyshim se krejt kjo është rezultat i injorancës (mosdijes) dhe inatit, mendjemadhësisë dhe mohimit të vërtetës, se përndryshe ata e kanë kuptuar se të parët e tyre është e paaftë dhe e dobët, andaj ata nuk kushtëzojnë për besimin dhe bindjen e tyre shumicën e gjërave të cilët i dëshmojnë dhe i shohin me sytë e tyre. Shembuj të gjallë kemi mësuesit dhe profesorët nxënësve të tyre për çdo ditë u shpjegojnë që mbi qindra gjëra të cilat nuk i shohin e as i dëshmojnë, mirëpo ata u besojnë mësimdhënësve të tyre. Gjithashtu mjekëve, inzhinierëve dhe shkencëtarëve tjerë u besojnë pabesimtarët kur lajmerojnë për shpikjet e tyre pa i parë ata se çka kanë shpikur. Nxehtësia e shkrin akullin ose të ftohtit e ngrin ujin, pabesimtari u beson këtyre pa e parë nxehtësinë dhe të ftohtin se si depërtojnë në to, por mjafton vetëm me pamjen e ndikimit të tyre.

Valët e radios janë ata që e shkaktojnë zërin, të cilin e dëgjon vetë nuk i ka parë edhe as mund t’i shohë ndonjëherë, por mjafton vetëm me atë që Shkaktojnë valët dhe se ato depërtojnë nëpër ajër, e njehta gjë ndodh edhe me televizorin e me telefonin.

Andaj u themi pabesimtarëve se: U mjafton ta ndiqni të njejtën rrugë d.m.th. ta kuptoni ndikimin e Zotit në krijesat e Tij, nëse doni të besoni dhe të bindeni se Zoti është Një. Për t'u kuptuar më qartë kjo që u lartpërmend dhe për të besuar duhet ndjekur dy gjera:

1.- që ta mesojë fenë e tij (Islame) prej njerëzve të drejtë dhe të specializuar në të si p.sh. pejgamberët dhe pas tyre dijetarët Islam dhe atë pasi të vërtetohet prej vërtetësisë së Kur'anit dhe argumenteve të tij.

2.- dhe pasi që t'i shoh gjurmët e Tij (Zotit) në krijesat e Veta, të cilat i mbushin qiejt dhe tokën dhe se nuk mund të jenë krejt këto maturi dhe përpikshmëri pa mos qenë ndokush që t'i projektojë ato. Nuk ekziston asnjë plan pa planifikuesin, as dituri pa dijetarin, as profesionist, as përpikshmëria pa atë i cili i përpikë gjërat e kështu me radhë. Mirëpo pabesimtarët nuk i lë inati, moskuptimi dhe mendjemadhësia që t'i nështrohen rregullit të Zotit.

“Dhe, edhe pse bindshëm të besueshëm në të (ishin nga Zoti i mohuan në mënyrë të padrejtë se çfarë ishte fundi i shkatërrimtarëve.“ (Ne ml: 14)

Këta lloj njerëzish janë shumë sikur që lajmëron All-llahu në Kur'an:

“Dhe kështu, Ne u futëm atë (dyshimin) në zemrat e kriminelëve. E ata nuk i besojnë atij (Kur'anit) derisa ta shohin dënimin e dhëmbshëm.“ (Shuara: 200-201)

PROPOZIM DHE KUSHTE

Ka një grup pabesimtarësh inatçi të cilët nuk thellohen në argumentet që ua ka sqaruar Zoti robërve të vet me krijesat e Tij dhe me të cilat argumente i ka dërguar peygamberët e Tij. Nuk e ndjekin rrugen e drejtë dhe të vërtetë, por krenohen ndaj Atij i Cili i ka krijuar ata prej ujit të turbullt (spermës) dhe nuk mendojnë se e kanë arritur atë gradë që ua bën të mundshme t'i propozojnë All-llahut se çfarë lloj sqarimesh dhe argumentesh pëlqejnë ata. Andaj filluan t'i propozojnë kushte All-llahut xh.sh., mirëpo edhe nëse Zoti u përgjigjej propozimeve dhe kushteve të tyre, nuk do t'u shtonte pabesimtarëve asgjë tjetër vetem se inat dhe refuzim. Në anën tjetër sikur t'u përgjigjej dëshirave të pavend, do të prisheshte rregulli i jetës në tokë dhe në qiej, sepse ndokush prej tyre kërkon prej Zotit që ta bëjë naten ditë, e dikush kërkon që t'i bëjë gratë burra ose të kundërtën, tjetërkush kërkon që Zoti t'ia vret armiqtë e tij, tjetri kërkon që All-llahu ta martojë me femrën që e ka dashuruar, tjetri po propozon që toka të bëhet qiell e qielli tokë, e tjetri kërkon që Zoti ta bëjë në gradë të peygamberëve e kështu me radhë, fol e mos u lodh, falë i qofshim Zotit, i Cili në lidhje me këta njerëz thotë kështu:

“E sikur të përputhej e vërteta me dëshirat e tyre, do të shkatërroheshin qiejt e toka dhe çdo gjë që gjendet në të.” (Mu'minun: 71)

Mirëpo All-llahun e Madhërisëm nuk mund ta çojnë kah të duan injorantët (xhahilët), sepse All-llahu fuqiptotë u ka sjellë njerezve lloj-lloj argumentesh dhe shumicën prej tyre ua ka shpjeguar atyre.

Në anën tjetër atyre u ka krijuar veshë, sy dhe zemra, prej të cilave kanë dobi vetëm besimtarët, kurse injorantët dhe pabesimtarët i mohojnë këto të mira prej Zotit dhe se kur u tërhiqet vërejtja atyre u shtohet edhe me shumë inati, andaj nuk kanë me çfarë të arsyetohen ditën e gjykimit. All-llahu xh.sh. thotë:

“Ata që kundorshtojnë fenë e All-llahut pasi që asaj i janë përgjigjur (njerëzit), faktet e tyre janë të asgjesuara te Zoti i tyre, ata janë të përbuzur dhe ata do të kenë denim të rëndë.” (Shura: 16)

Ne lidhje me këto Kur’ani famëlartë na tregon disa shembuj praktikë për propozuesit dhe kushtëzuesit inatçi dhe pabesimtarë. Si shembull të parë i kemi çifutët (jehudët) të cilët i thanë Musait a.s.:

“Dhe kur i thatë: ‘O Musa, ne nuk të besojmë ty derisa të shohim All-llahun haptazi, e atëherë juve u rrëmbeu rrufeja (zjarri) dhe ju e shihnit. Pastaj që të jeni mirënjohës pas vdekjes suaj juve ju ngjallëm.’” (Bekare: 56)

Pabesimtarët e kurejshitëve i thanë peygamberit a.s.:

“Ata thanë: ‘Nuk të besojmë ty deri që të na nxjerrësh prej tokës burime. Ose, (nuk të besojmë deri që) të kesh kopshte me hurma e me rrush, e të bësh të rrjedhin vazhdimisht lumenjë në mesin e tyre. Ose (nuk të besojmë derisa) të bjerë mbi ne qielli copa-copa, ashtu si po mendon ti (se do të na dënojë Zoti), apo të na sjellësh All-llahun dhe engjëjt pranë nesh. Ose të kesh një shtëpi prej ari, apo të ngjitesh lart në qiell, po ne nuk të besojmë për ngjitjen tënde derisa të na sjellësh një libër që ta lexojmë?!’ Thuaj: ‘Subhanall-llah – i Madhërishëm është Zoti im, a mos jam unë tjetër vetëm se njeri peygamber?’” (Isra: 90-93)

Gjithashtu çifutet (jehudët) e Medinës e kanë këshilluar njëri-tjetrin që t'i përdorin të njëjtat metoda sikurse që i kanë përdorur të parët e tyre. Zoti xh.sh. thotë:

“Një grup nga ithtarët e librit thanë (të vetëve):

“Besoni paradite në atë që u është shpallur atyre që besuan (muslimanëve), e pasdite mos e besoni, ndoshta edhe ata (muslimanët) do të zbrapsen (nga besimi i tyre). Dhe (u thonin): Mos i besoni askujt përveç atij që është në fenë tuaj!’ Thuaj: (o i dërguar) ‘I vetmi udhëzim është udhëzimi nga All-llahu!’ (u thoni të vetëve mos besoni nga droja) se po i jepet ndokujt (pejgamberllëku) sikurse u është dhënë juve dhe (nga droja) se do t’ju paraqesin fakte (mushimanët) para Zotit tuaj (ditën e gjykimit). Thuaju: ‘E tërë e mira është në duar të All-llahut, Ai ia jep atë kujt të dojë, All-llahu është dhurues i gjërë; i gjithdijshëm.’“ (Ali-Imran: 72-73)

Kështu pra, i çoi jehudët (çifutet) zilia dhe armiqësia deri te mohimi i argumenteve të cilat i ka dërguar Zoti nëpërmes pejgamberit, i cili nuk ishte me origjinë jehude.

Ky grup (jehudësh) ka vazhduar aktivitetin e vet gjatë kohës deri sot e kësaj dite, duke mbajtur të njëjtin qëndrim ndaj pejgamberëve të All-llahut xh.sh.

“Dhe ashtu (në Mekë) në çdo qytet kemi bërë kriminelët e tij pari në mënyrë që të bëjnë dredhi në të, por nuk mashtrojnë tjetër kë pos vetën e tyre dhe prapëseprapë nuk kuptojnë. E kur u vjen atyre ndonjë argument i prerë (për Muhammedin), ata thonë ‘Kursesi nuk e besojmë atë (dërgesën e Muhammedit) derisa të mos na jepet edhe neve ngjajshëm me atë që iu patë dhënë të dërguarve të All-llahut! Më së miri All-llahu e di ku ta vërë dërgesën (risalen) e vet. Ata që bëjnë krim do t’i godasë poshtërimi dhe dënimi i fortë te All-llahu për shkak se vazhdimisht bënin hile.

Atë që All-llahu dëshiron ta udhëzojë ia zgjëron zemrën për (të pranuar) Islamin. Atë që dëshiron ta lërë të humbur zemrën e tij ia bën shumë të ngushtë sikur të ngjitej në qiell. Kështu All-llahu lishon dënimin mbi ata që nuk besojnë.“ (En’am: 123-125)

Këta janë prijësit e krijimeve në çdo kohë dhe vend shpikin dyshime për t’i mashtruar dhe larguar njerëzit nga rruga e Zotit të Madhërisëm dhe parashtrajnë kushte të cilat tregojnë mendjemadhësinë e tyre ndaj të vërtetës. Andaj i shohim ata duke kërkuar që çdonjeri prej tyre të ketë lidhje dhe vend të posaçëm te Zoti sikur që kanë pejgamberët e Tij. Ndërsa All-llahu di më mirë ku e zbret shpalljen e Tij. Për këta mendjemëdhenj Zoti ka përgatitur nënçmim dhe poshtërim, kurse atij për të cilin di Zoti se do të udhëzohet dhe do ta dojë të vërtetën, ia hap dhe zgjeron zemrën për njohjen dhe mësimin e fesë Islame, ndërsa atij për të cilin di Zoti që nuk beson e as që udhëzohet ia hap dyert e humbjes (kufrit) sikur që tregon All-llahu xh.sh. në Kur’an:

“Kurse ata që gjetën rrugën e drejtë, Ai atyre u shton edhe më udhëzimin në rrugën e drejtë dhe u ofron mundësi të jenë edhe më të matur.” (Muhammed:17)

“...E kur ata u shmangën (nga e vërteta), All-llahu i largoi zemrat e tyre, pse All-llahu nuk e vë në rrugë të drejtë popullin e prishur.” (Saff: 5)

Shenja e pabesimtanit shihet në largimin e tij nga kuvendimet, shpjegimet dhe këshillat Islame, ndaj të cilave i shtohet ngushtimi edhe më tepër kur i përmendet dhe përkujtohet feja e All-llahut xh.sh., i mbyllet zemra dhe i ngushtohet krejtësisht kështu që gjendja e tij është e ngjashme me gjendjen e atij që ngjitet në qiell si aeroplani kështu që sa me lartë të ngritet aq më shumë i ngushtohet zemra, sa që detyrohet të përdorë mjete të ndryshme për frymëmarrje që ua lehtëson

atë ngushtesë që ua kaplon zemrat e tyre. Andaj nuk ka gjë më të vërtetë se sa argumentet e Zotit për bindjen e njerëzve. Pra, kush dëshiron udhëzim le të hapë zemrën për Islam, le të hulumtojë për argumentet e besimit, le të ketë kujdes ndaj dyshimeve të kriminelëve, mendjemëdhenjve dhe t'i pyetë ata të cilët e ndjekin rrugën e besimit që t'i shoqërojë në atë udhëtim derisa të arrijnë të gjithë në fundin e rrugës së drejtë, ku do ta gjejnë vetën para xhennetit, gjërësia e të cilit është sa qiejt dhe Toka dhe që është përgatitur për besimtarët. Andaj ju të cilët dëshironi udhëtim për në xhennet kjo është rruga e besimit, ndiqni atë, shoqëroni besimtarët që t'ju ndihmojnë gjatë udhëtimit, keni kujdes për ndjekjen e rrugës që na çon në xhehennem dhe gjithashtu largojuni shoqërimin që ndjek rrugën e pabesimit në mënyrë të mos bëhesh prej atyre që do të pendohen ditën e gjykimit, për të cilët flet Kur'ani i nderhem:

“Atë ditë zullumqari do t'i kafshojë duart e veta edhe të thotë: I mjeri unë ta kisha marrë rrugën e pejgamberit O shkatërrimi im, ah të mos e kasha bërë filanin mik! Në të vërtetë, pasi e gjeta rrugën e drejtë, ai më largoi mua prej asaj e djalli është ai që njeriun e humb dhe e lë të vetmuar.“
(Furkan: 27-29)

Kjo është rruga e besimit. Rruga e dijes dhe njohurisë. Rruga e ngritjes në gradat e larta:

“...All-llahu lartëson ata që besuan prej jush, i lartëson në shkallë të lartë ata të cilëve u është dhënë dituri...” (Muxhadele: 11)

Velhamdulil-lahi rrabbil alemin ve sal-lall-llahu ala Muhammed ve ala alihi ve sahibihi exhmein!